



## KUVENDI I KOMUNËS

### Procesverbal nga mbledhja e XVIII-të (tetëmbëdhjetë)-e rregullt, mandati VII-të, mbajtur më 09 dhjetor 2022.

Mbledhja filloi në orën 10;20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

(Nga LDK Valon Demolli; Demokrat Hodolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Adnan Zymeri; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta, Fahri Hasani.

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi. Nga PDK, Bashkim Syla; Endritë Murati; Mimoza Abdullahu. Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu. Nga OBKD, Gazmend Islami.

Gjithashtu i pranishëm ishte z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës, znj.Marigona Lahu Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

*(Antoneta Ejupi-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla Uka-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE)*

I pranishëm ishte përfaqësues të KFOR, përfaqësues të OSBE, përfaqësues të mediave lokale dhe disa zyrtar komunal.

### Rendi i Ditës

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë në këtë mbledhje, si dhe duke informuar rreth konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa. Konstatoi kuorumin, të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Kuvendit, dhe në vazhdim theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën lidhur me rendin e ditës.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, kam propozim për dy pika shtesë në kuadër të rendit të ditës, pika këto të cilat edhe në mbledhjen e KPF-së janë propozuara dhe kemi provuar t'i sjellim si rekomandim në Kuvend por që asnjëra nuk mori shumicën kualifikuese në KPF, andaj dua që edhe para juve si këshilltar të Kuvendit si grup më i gjerë vendimmarrës t'i paraqes këto dy pika.

I nderuar Kryesues, paksa me vonesë e kërkova fjalën ngase kur Ti e hape mbledhjen e potencove se kjo mbledhje është e 8-ta e këtij mandati, e që në fakt është e 18-ta.

Pikat që unë do t'i propozoj janë këto si në vijim:

1-Bazuar në Rregulloren e Kuvendit të Komunës datë 31 janar 2011 për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse, gjegjësisht duke u bazuar në nenin 12 të kësaj rregulloreje, po citoj këtë nen, *me kërkesë të qytetarëve apo të ndonjë subjekti apo të përfaqësuesve të mjeteve të informimit mund të bëhet audio, ose video transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve të Kuvendit, përkatësisht mbledhjeve të trupave punuese të Kuvendit*, andaj propozoj që seancat e Kuvendit,

apo më mirë të them që ta fusim këtë rregullore në funksion ashtu siç na obligon neni përkatës i rregullores së punës së Kuvendit. Një qeverisje e mirë, një prej komponentëve kryesore të saj janë llogaridhënia dhe transparencja, prandaj unë mendoj që ne sot duhet të marrim vendim, apo më mirë të them që të apelojmë që kjo Rregullore të hynë në funksion.

2-në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit, është në kompetencën e Kuvendit që të formoj komisione ad-hoc, andaj propozoj që të formohet një komision ad-hoc, eventualisht dy komisione, mirëpo që në rast se hynë si pikë e rendit të ditës mund t'i diskutojmë detajet gjatë debateve pastaj, për monitorimin e ndarjes së subvencioneve. Jemi në dijeni se në buxhetin komunal, një pjesë e mirë e tij, mbi 1 milion euro është në këtë kategori buxhetore, dhe do të doja që ta formojmë një komision ad-hoc i cili do të merret me monitorimin, gjegjësisht për shkeljet eventuale apo lëvdatat që mund t'i gjejmë në ndarjen e subvencioneve, bursave dhe subvencioneve tjera.

Pra këto janë 2 pikat që deshta t'i propozoj që të futen si pika shtesë në kuadër të rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sa i përket kësaj mbledhje ndoshta kam gabuar dhe e kam thënë mbledhja e 8-të, mirëpo kjo mbledhje është e 18-ta e këtij mandati. Ndërsa sa i përket pikave të propozuara shtesë nga parafolësi, ndoshta do të ishte mirë të na dorëzoheshin me shkrim.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar Kryesues, jam në dijeni se ajo që e potencove është njëra prej formave të paraqitjes së propozimeve e që dyja format e kanë validitetin e njëjtë, por unë sot nuk i kam të shkruara, mirëpo i shpreha në foltore të 2 propozimet.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, qëllimi ishte vetëm që t'i lexoj sakt propozimet e bëra, jo për diçka tjetër. Ju informoj se kjo sallë e Kuvendit është pajisur tash së fundmi me kamera të reja dhe transmetimi bëhet përmes faqes zyrtare të Komunës dhe përmes rrjetit social facebook, kështu që transmetimi ekziston, ndërsa përse nuk është ndonjë TV në transmetim unë nuk e di mirëpo të gjitha TV-të dhe media tjera janë të lejuara t'i përcjellin dhe t'i transmetojnë mbledhjet e Kuvendit pa kurrfarë problemi, mundësit dhe hapësira ju krijohet.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, unë në foltore e përmenda një rregullore të Kuvendit të Komunës, Rregullore e cila e obligon Kuvendin, apo ky Kuvend mund ta shfuqizoj këtë Rregullore. Prandaj me këtë Rregullore që kemi na jepet mundësia që të bëjmë kërkesë për transmetim të seancave drejtpërdrejtë.

Jemi në dijeni se ekzistojnë kamerat në këtë sallë, por pa dashur të hyjmë në detaje tjera këto janë kamera të sigurisë e që ne ndoshta nuk e kemi as të drejtën që drejtpërdrejtë të kemi qasje sepse sigurisht jeni në dijeni se kush i monitoron ato, pra ne si Kuvend nuk jemi një organ i cili mund t'i vë ashtu siç janë, por në një formë këto kamera janë në dorën e dikujt tjetër që i kontrollojnë, ndërsa mediat e pavarura e kanë rolin tjetër dhe në këtë aspekt unë vetëm deshta krejt atë që e thotë rregullorja e cekur.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, kërkoj 2 minuta pauzë, me qëllim të konsultimeve me shefin e Grupit të këshilltarëve të LVV-së lidhur me këto dy pika që u propozuan.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, kërkoj që pauza të jetë të paktën 10 minuta sepse nuk mund të ketë pauzë e as kurrfarë konsultimi për 2 minuta.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, për 2 minuta mendoj se janë pak për tu konsultuar, mirëpo nëse jeni të pajtimit shkojmë me 10 minuta pauzë.

*Përkrahet propozimi për pauzë 10 minuta.*

*Pas pauzës prej 15 minuta, mbledhja vazhdon duke filluar në ora 10:40*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, e vazhdojmë mbledhjen aty ku mbetëm, kuorumi ekziston (prezent të gjithë anëtarët e Kuvendit) andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të propozuar të ditës, nëse jo atëherë i hedhim në votim propozimet e paraqitura nga anëtari i Kuvendit z.Naim Çunaku, duke filluar nga propozimi i parë që mbledhjet e Kuvendit të transmetohet drejtpërdrejt nga ndonjë Televizion, përveç që transmetimi bëhet drejtpërdrejtë përmes Youtube dhe faqes zyrtare të Komunës .

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se meqë 16 vota ishin Për, 19 vota Kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur, nuk mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës edhe pikën shtesë; Transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave të Kuvendit të Komunës përmes ndonjë Televizioni*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani e hedhim në votim propozimin tjetër që ishte formimi i një komisioni ad-hoc për monitorimin e ndarjes së subvencioneve dhe bursave në vitin 2022, që kjo të përfshihet në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se meqë 16 vota ishin Për, 18 vota Kundër dhe 1 votë e Përmbajtur, nuk mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës edhe pikën shtesë; formimi i një komisioni për monitorimin e ndarjes së subvencioneve dhe bursave në vitin 2022*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani kalojmë në rendit të ditës të cilin sigurisht se e keni marrë me kohë së bashku me materialin përkatës dhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF e mbajtur një ditë më parë, andaj e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës si dhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja KPF-së.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 35 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent, me 19 vota Për, asnjë votë kundër dhe asnjë votë e përmbajtur (të tjerët nuk morën pjesë në votim), miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, përfshirë edhe kontaktimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e datës 08.12.2022, ku përfshihen:*

*-Lista (e re me përditësime) e veçantë e pronave të Komunës të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2023,*

*-Rishqyrtimi i Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale, (pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës).*

*-Rishqyrtimi i vendimit për formimi i komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës (pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës)*

**z.Naim Çunaku**, pyeti kryesuesin e Kuvendit, cili rend i ditës u miratua, a mund të na sqarosh këtë, dhe theksoi, e them këtë sepse duhet t'i lexosh pikat e rendit të ditës, rekomandimet e KPF-së, pikat e shtesë të rekomanduara.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i'u përgjigjur parafolësisht, theksoi, unë jam i informuar se materiali 'ju është shpërndarë të gjithëve me kohë, po ashtu konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së, llaptopët i keni të gjithë, andaj nuk e shohë të arsyeshme t'i lexoj serish.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar Kryesues jeni duke bërë shkelje, por vazhdo nuk është telashe sepse nuk është as e para e as e fundit kjo.

*Rendi i miratuar i ditës:*

- 1. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 e Komunës së Podujevës*
- 2. Propozim vendimi për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës*
- 3. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023*
- 4. Rishqyrtimi i Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba Komunal*
- 5. Rishqyrtimi i Vendimit për koordinimin e procesit dhe zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin Komunës së Podujevës*
- 6. Të ndryshme*

## **1. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 e Komunës së Podujevës**

**z.Hilmi Hoxha**, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jam në dijeni se ky dokument ka kaluar të gjitha procedurat dhe tani është sjellë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim final, andaj fjalën hyrëse rreth këtij dokumenti i'a kalojmë drejtorit të Drejtorisë përkatëse.

**z.Vigan Salihu**, drejtor i DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, pran vetes keni një nga dokumentet më të rëndësishme të Komunës së Podujevës që është Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2023-2025, dokument i cili është hartuar duke u bazuar në udhëzuesin e përgatitur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe në bazë të Ligjit 03/L-040 për vetëqeverisje lokale. Gjithashtu ky dokument ka kaluar të gjitha procedurat të parapara dhe tani është në fazën filane për miratim, andaj kërkoj nga ju si Kuvend që ta mbështesim këtë dokument si dhe po ashtu kërkoj nga Ju që të jepni kontributin e juaj në këtë dokument.

**z.Adnan Zymeri**, theksoi, fillimisht i nderuar Kryesues i Kuvendit shfrytëzoj nga rasti të përgëzoj për prezantimin dinjitoz gjatë vizitave të fundit të kishim në Shkodër dhe në Ulqin.

Sa herë që diskutojmë për strategji dhe dokumente të rëndësishme rreth zhvillimit ekonomik lokal, krahas hartimit duhet të mendojmë edhe për mundësinë e realizmit të asaj që thuhet në dokument, prandaj dokumente të tilla sikur ky i sotmi duhet të hartohen me kujdes e përpikëri, kurse në këtë Strategji fatkeqësisht nuk e gjen asnjërin. Qysh në faqen e parë herë referohet si draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e herë Strategjia Zhvillimore Lokale, në dukje gabim teknik por kushdo që e ka lexuar këtë draft e dinë se gabimi është përmbajtjesor, mirëpo kur nuk ke kapacitete të brendshme për të hartuar një dokument të tillë detyrohesh ta kontraktosh dikë nga jashtë por që pastaj këta brenda nuk mund ta korrigjojnë këtë të jashtëmin, por si do qoftë në metodologjinë e përdorur gjatë hartimit të këtij dokumenti thuhet se janë përfshirë Sektori privat, Shoqëria Civile, qytetarët e të tjerë, e bukur për ta besuar sikur të mos e tregonin të kundërtën procesverbalet dhe vetë Strategjia në të cilën nuk janë paraqitur as partnerët e as ekipa punuese siç ndodh rëndomtë në përmbajtjet e dokumentit. Po ashtu në metodologjinë e hartimit të këtij dokumenti tregohet se kjo Strategji është e bazuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe buxhetin e që fatkeqësisht nuk reflektojnë asgjë me qëllimet e Strategjisë, për çudi nuk merret parasysh strategjia e fundit e miratuar, por ajo paraprake. Të gjitha këto për të hartuar 85 faqe dokument, 18 faqe përmbajtje e që gjithçka mund të jetë por vetëm strategji nuk është. Për të përmbushur funksionin e saj Strategjia duhet të reflektoj në buxhet për të parë ndërlidhshmërin e SWOT-it me buxhetin duke i kthyer elementet e analizës SWOT në projekte që do të zvogëlonin rreziqet e do t'i rrisnin mundësitë ashtu që do të shndërronin dobësitë në përparësi.

Ndër përparësitë e evidentuar janë, moshë e re e popullsisë, mirëpo çfarë është duke bërë Komuna e Podujevës për punësimin e të rinjve, pastaj tradita në zhvillimin e tregtisë, mirëpo çfarë është duke bërë Komuna e Podujevës për bizneset, mandej përveç përparësive këtu evidentohen edhe dobësi ndër të cilat është edhe qasja e pamjaftueshme në fondet investive, dhe tani pyes a nuk po ka fonde apo nuk po ka

Komuna njerëz që aplikojnë në ato fonde apo po mjaftoheni me fondet e Elvis Naçi dhe Halil Kastratit, me gjithë respektin për këta të dy.

Një tjetër dobësi e evidentuar është dominimi i bizneseve me veprimtari tregtare dhe shërbyese, a më thoni se kush është investitori i fundit që ka ardhur për të investuar në Podujevë, pastaj mos zhvillimi dhe mos promovimi i mjaftueshëm i zonave turistike dhe rekreacionit, sa mjete buxhetore ka ndarë Komunës në buxhetin e vitit të ardhshëm për ta kthyer këtë dobësi në përparësi. Krahas mundësive ekzistojnë gjithashtu edhe rreziqet e kësaj Strategjie, nxitja e rritjes së eksportit të produkteve vendore shihet si mundësi mirëpo eksporti nuk rritet duke evidentuar listat e eksportuesve dhe kaq. Ndër rreziqet e kësaj Strategjie dhe Komunës në tërësi është mungesa e donatorëve për investime andaj si do ta kthejë Komuna këtë rrezik në përparësi. Ndërsa se ky dokument paraqet një kopje të keqe të Strategjive të mëparshme tregon fakti se në vizionin e Strategjive të mëparshme vizioni i Podujevës deklarohet si Komunë e suksesshme me mundësi të barabartë për të gjithë, ndërsa në këtë Strategji i shtohet edhe pjesa, me mundësi të barabarta për burrat dhe grat e saj, mirëpo as vizioni e as misioni nuk jetësohet pa objektiva të qarta e për të përcaktuar objektiva të qarta duhet që ato objektiva të jenë SMART, specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe në kohë, ndërsa asnjë nga specifikat e qëllimeve strategjike nuk i përmbajnë këto elemente, elemente të cilat do t'i shndërronin këto objektiva nga objektiva "sa për sy e faqe" në objektiva të realizueshme, shembull, zhvillimi dhe përmirësimi i ambientit të të bërit biznes thuhet se do të bëhet, pa specifikuar numrin e ndërmarrjeve që do të subvencionohen, periudhën kohor, kapacitetet e mbulueshmërisë, ndërsa nxitja për eksport është planifikuar të bëhet vetëm me atë listën që e ceka më herët, dhe atë deri në vitin 2025.

Qëllimet tjera strategjike të listuar janë thjesht grumbull i projekteve të paspecifikuara sa për të shtuar volumin e faqeve të këtij dokumenti pa mbikëqyrje, prandaj një Strategji e hartuar keq, pa qëllime të planifikuara, pa objektiva të qarta, me vizion e mision të kopjuar, pa ndërlidhje me buxhetin, pa definim të elementeve bazë strategjike dhe aq më tepër e sponsorizuar nga dikush që ka bërë mrekulli në bujqësi e tani po udhëheqë me ekonominë, nuk meriton të kaloj tutje, prandaj LDK do të votoj kundër.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 e Komunës së Podujevës është një prej Strategjive më të mira që kanë Komunitat në nivel vendi, është një Strategji e punuar në mënyrë profesionale e cila është në harmoni të plotë me buxhetin dhe në harmoni të plotë me Kornizën Afatmesme Buxhetore, pra nëse i shikojmë shtojcat mund të shohim se është në përputhje të plotë edhe me planet buxhetore që i ka Komuna.

Në këtë Strategji kemi fokuse të qarta dhe konkrete ku përfshihen zhvillimi ekonomik, me theks modernizimin e bujqësisë dhe blegtorisë, pastaj investimet në arsim, shëndetësi, kulturë, sport, infrastrukturë dhe shumë projekte tjera të rëndësishme të cilat e dërgojnë Komunën e Podujevës drejt zhvillimeve të përgjithshme dhe progresive, prandaj ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë Strategji.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, në mbledhjen e KPF-së unë i kam dhënë vërejtjet e mia të cilat po ashtu me shkrim i kam dorëzuar drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik. Për disa vërejtje qysh një ditë më parë kam marrë sqarime edhe nga drejtori i Drejtorisë së cekur, kështu që ne Grupi i PDK-së do të votojmë Për, këtë dokument të SZHEL 2023-2025 të Komunës së Podujevës.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, pa dashur t'i përsërisë ato që i potencuan parafolësit po mundohem të jem më konkret rreth asaj çka pash në këtë strategji dhe po e përdori një fjalë të një miku tim kur kemi biseduar për një strategji, ndjesë pastë e që po dëshiroj të citoj atë fjalë, vetë nocioni Strategji kuptojmë një diçka, një vizion, një mision dhe një qëllim drejt një të ardhme, ndërsa kjo Strategji të cilën e kemi paravetës është duke i'u shkuar mbrapa Strategjisë, gjegjësisht zhvillimi, mirëqenie dhe stadi ku jemi ne është duke shkuar dhe duke i prirë asaj në atë që është thirrë Strategjia dhe që ka marrë si pikë referente. Pa dashur të jem i gjatë në diskutim, që në hyrje të këtij dokumenti nuk kemi një kosto të kësaj Strategjie dhe nuk do të duhej të ishte një dokument i tillë pa pasur një akterët që e kanë bërë këtë Strategji.

Ne jemi në dijeni se është një kompani e cila e ka hartuar këtë dhe dihet si bëhet një Strategji kur bëhet nga një kompani ku nuk merr asnjë input ose karakteristikë të vendit për ku bëhet strategjia, dhe për ta ilustruar këtë që po e them, po nisem nga ajo që figuron në faqen 40 si ndarje administrative të Komunës së Podujevës, dhe si e përcakton këtë ndarje administrative duke i'u referuar ndarjes administrative para vitit 2000 kur Komuna e Podujevës ka qenë e organizuar në 18 bashkësi lokale, dhe atë e kemi sot këtu në këtë dokument si ndarje administrative të Komunës.

Kemi çështjen ku është cekur uji i pijshëm, thuhet se Komuna e Podujevës ka afërsisht 88500 banorë dhe kur e cilëson se sa janë të furnizuar me ujë të pijes nga sistemi i ujësjellësit përmendet një shifër prej 71.5 përderisa i referohet numrit 87370, do të thotë se 71% i 88500 nuk mundet asesi ta bëjë shifrën 87370.

Po ashtu diçka që më ngriti shqetësim është çështja me gjendjen e arsimit në Komunën e Podujevës, që është përfshirë në këtë dokument, dhe po i potencoj takstativisht gjërat që nuk u than nga parafolësit dhe atë ne lexoj specifikisht, i'u ka referuar vitit shkollor 2022 dhe 2023, në arsimin fillor e kemi një shifër 5842, në arsimin e ciklit të mesëm të ulët na del një shifër 4268 nxënës dhe është shqetësuese se pa e ditë se ku po mbesin diferenca prej 1574 nxënës, çfarë bëhet me ata nxënës, a e kanë ndërprerë mësimin apo çfarë sepse në bazë të këtij dokumenti ata nxënës nuk figurojnë, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë kjo shifër reduktohet edhe më shumë dhe del 3360 e që sërish e kemi të pashpjegueshme se ku mbretën 2482 nxënës. Për fund e them se një Strategji Zhvillimore kur një prej elementeve kryesore që e rëndon ose tek qytetarët e Komunës së Podujevës do ta zinte vendin e parë si shqetësim qytetar re kemi gjendjen e ambientit, e që disa prej neve jemi këtu dëshmitarë por ka edhe disa prej tyre që mund të jenë dëshmitar por jo pjesëmarrës në atë, të përmendësh një Strategji Zhvillimore 2023-2025 dhe të mos parashohësh asgjë për trajtimin e ujërave të zeza e që lumenjtë janë shndërruar në kanale të hapura të kanalizimeve, dhe të mos parashohësh asgjë se si ta zgjidhësh këtë problem është më tepër se sa papërgjegjësi.

Ne jemi dëshmitar se kemi pasë të iniciuar një kolektor dhe Komuna e Podujevës ka hyrë në obligime financiare në një Bankë Austriake mbi 5 milion euro, dhe ai kolektor ka filluar por që ka 2 vite që nuk punohet asgjë në të, greis periudha ka qenë 5 vite e që në vitin e ardhshëm do të arritim si Komunë dhe si qytetarë ku nga taksat e tyre do të paguhet kamati / interes për një projekt që nuk e sheh. Pa dashtë të hyjë në atë se a ka qenë projekt i mirë apo projekt i keq, nëse ndokush mendon se diçka ka shkuar keq, dhe pse ka shkuar keq të mos veproj asgjë, mos veprimi është i barabartë me qëllimin e keq, arsyeja përse e them këtë është se kush do qoftë ai, çfarëdo emri ka ai, i cilës parti qoftë ai, nuk guxon që në këtë masë të heq dorë prej një projekti crucial për jetën e qytetarëve. Autoriteti që tani ka edhe qeverisjen në Komunë e ka edhe për obligim të zhvillojnë procedura qoftë edhe hetuese dhe gjithë ata që gjenden në faj, janë organet në të cilat duhet të iniciohen, mirëpo të mos parashohësh asgjë për ndotjen e ambientit gjegjësisht për helmimin që bëhet nga ujërat e pa trajtuara që rrjedhin nëpër lumenj është më tepër se sa papërgjegjësi.

Po e përfundoj me këtë, të gjithë këtu jemi në një sallë që nuk i plotëson as kushtet ligjore për mbajtjen e seancave, arsyeja përse po e them se nuk i përmbush kushtet është sepse salla e Kuvendit Komunal duhet të ketë hapësirë për qytetarë, ndërsa e dim në çfarë salle jemi por që as për këtë sallë nuk është provuar që të jetë të paktën diku për zgjedhje të kësaj çështje, qoftë salla e vjetër që është në objektin i cili është objekt i mbrojtur qoftë diku tjetër.

Për fund po e përmbylli diskutimin me një urim që e kam potencuar edhe një ditë më parë në mbledhjen e KPF-së, kjo kosto financiare ku janë një kallaballëk i projekteve nuk kanë kosto të specifikuar financiare në këtë Strategji, nëse arrin të përmbushet me gjitha ato projekte që i kam parë për këto vite, vërtetë meriton lëvdatë nëse arrin që me 50 milion euro t'i përmbushë, andaj kjo më ngjan me një dokument të mirë për sy, të mirë për ta lexuar, një fontanë dëshirash e që unë do të doja që të mos jetë fontanë dëshirash por të jetë realitet.

**z.Gazmend Islami**, theksoi, e kam lexuar Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 të Komunës së Podujevës, mirëpo fillimisht një pjesë të kohës po dëshiroj të flas për qytetin tonë si lokalitet se ku jemi sot. Dëgjova parafolësit se në çfarë gjendje është Komuna e Podujevës, pra është Komuna më e varfër thuajse në Kosovë, mirëpo përse kemi ardh deri këtu çdoherë kërkohet ai çelësi përse jemi Komuna më e varfër në Kosovë, çka është punuar për këto 23 vite dhe çka mund të bëjmë mirë për qytetarët tanë. Është shumë e rrugës dhe do kërkoja edhe prej pozitës që kur kemi të bëjmë diçka për të mirën e qytetarëve duhet të bashkëpunohet më shumë me opozitën dhe jo të mbivotohet shembull nëse ndonjë propozim vie nga opozita për të mirën e qytetarëve, pra inatet dhe xhelozitë politike shkojnë e vinë kurse qyteti mbetet këtu, zhvillimi ekonomik mbetet këtu, kështu që shpirti i qytetarëve pret diçka prej neve si të zgjedhurit e tyre sepse vitet shkojnë shpejt e që edhe 2-3 vite dhe shumë prej neve këtu nuk do të jenë më në këto ulëse dhe çka mund t'i themi dikujt që kemi bërë përveç polarizimeve pozitive opozitë, pra pa e pasë kurrë një arsyeshmëri të dy anshme për të mirën e qytetarëve.

Nëse themi se Komuna e Podujevës është një Komunë pa strategji, unë e kam lexuar këtë draft të strategjisë dhe kam parë se ka shumë gjëra të mira, ka vend për përmirësime, a mund të realizohen nuk e di sepse nuk jam ekspert i fushës por nëse arrihet të bëhet kjo çfarë është shkruar në letër është mirë, por ne duhet të punojmë bashkërisht pozitive opozitë, si të sjellim investitorë të huaj, si mund ta ndryshojmë pamjen e këtij qyteti, pastaj mund të shihni se janë ikur jashtë shtetit shumë të rinjë dhe nëse vazhdon ky trend i mos zhvillimit ekonomik të kësaj Komune, në 2-3 vitet e ardhshme nuk do të kemi kë ta përfaqësojmë më. Po më vie keq prej kolegëve nga opozita të cilët i kam miq, por një bazë të përgjegjësisë e kanë edhe ata sepse kanë udhëhequr mbi 20 vite me këtë Komunë dhe asnjëherë nuk keni mundur të sjellëni ndonjë investitorë të huaj, e them këtë sepse duhet të mësohemi të flasim drejtë, unë e përkrahi çdo herë opozitën sepse edhe vet unë jam opozitë, pot ë doja pozitive do të bëhesha me pozitën që është në udhëheqje të Komunës, por duhet të jemi të sinqertë dhe fajet t'i marrim bashkërisht të gjithë, por edhe të mirat edhe të këqijat. Sa i përket kësaj salle të mbledhjeve të Kuvendit, Ju (i'u drejtohet Ekzekutivit të Komunës) jeni zgjedh për të ndryshuar dhe tani edhe për këtë sallë ju takon që ta ndryshoni. Prandaj kur është puna për të mirën e qytetarëve duhet të kemi shpirtë paksa më liberal dhe të mundohemi që këtij qyteti t'i japim një frymë të re, ngase pas 4 viteve mandat kur te kryejmë këtë do të na thonë jashtë shikoni këta hiç, prej hiç, për hiç dhe që nuk kanë bërë bash hiç asgjë, andaj kjo do të sihte e keqe.

Për opozitën po më vie keq sepse pozita i ka numrat dhe po manipulon me numra duke na mbivotuar kështu që edhe këta të pozitës duhet ta kenë shpirtin paksa më të butë, e në këtë rast kur kemi të bëjmë me këtë dokument të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik duhet të merren edhe mendimet e ekspertëve të pozitës dhe të bëhet bashkërisht sepse asgjë të keqe nuk kemi mes vete sepse të gjithë bashkë po rrimë në hollë këtu dhe po dalim për kafe dhe për ushqim dhe po qëndrojmë bashkë, mirëpo këtu në Kuvend krijohet përshtypja se jemi duke u prerë me sëpata mes vete.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, nga parafolësi u sugjerua dhe u aludua tek opozita e që në këtë rast jemi ne, po ashtu u aludua edhe për sallën e këtij Kuvendi.....

**Kryesuesi i Kuvendit**, i'a rikujtoj se nuk të është përmendur emri por mund të vazhdosh 3 minuta i ke.

**z.Naim Çunaku**, vazhdoi, në rregull Kryesues vetëm nga tani lëshoje matësin e kohës sepse më ndërpreve deri tani dhe kjo qasje nuk të qon askund, je në rrugë të gabuar Kryesues, unë të vlerësoj sepse pak më parë e kisha një propozim dhe e hedhe në votim propozimin e Naimit, mirëpo unë propozova pak më ndryshe, votuat kundër Rregullores së Kuvendit pa e shfuqizuar fare atë, por në rregull është vazhdoje, mirëpo më lërë ta vazhdoj unë diskutimin për çka e mora fjalën.

I nderuar z.Gazmend Islami, me gjithë respektin për ju, por nëse është arsyetim për dikë në vitin 2022 dhe që ka marrë besimin e qytetarëve për të ecë përpara, kurse ecë mbrapsht duke shikuar çka kanë bërë ata të tjerët përpara, të jesh i bindur se nuk do të arrijmë askund. Gjithkush për të bërë të tij e ka një faturë, ka një llogari dhe për atë edhe organizohen zgjedhjet dhe secili e paguan faturën e vet, mirëpo të pretendosh se

ke marrë dikë t'ia trasosh rrugën për të ecë përpara, dhe në anën tjetër thirresh në të këqijat e dikujt, nuk më duke e mirë kjo.

Kryetari i Komunës tani doli dhe nuk është prezent, mirëpo e foli një fjalë nga vendi duke potencuar se këtë sallë të Kuvendit e kemi gjetur kështu, e për këtë mund të them se nuk është ndonjë shpikje e ujit të nxehtë sepse të gjithë e dimë, mirëpo edhe atëherë por edhe sot kjo sallë është në kundërshtim me Ligjin për pjesëmarrjen e publikut në sallë, dhe këtë gjë e kam dëgjuar edhe prej Kryesuesit të Kuvendit dhe e diskutojmë të gjithë, mirëpo ne jemi këtu për të bërë zgjidhje, nëse kjo sallë është e keqe nuk na ndalon askush për të bërë diçka të mirë, prandaj edhe unë mendova që në një Strategji Zhvillimore për 3 vitet e ardhshme do të duhej ta kishte ndokush në mendje këtë gjë apo këtë defekt që jemi sot.

**z.Gazmend Islami**, theksoi, unë nuk e kritikova askënd në fjalimin paraprak edhe pse parafolësi zotëri Çunaku menjëherë reagoj. Ideja ime çdoherë është për bashkëpunim, shembull, nëse opozita ka ide kreative unë gjithëherë jam në krah të tyre, mirëpo tani kur jemi te Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal, ka të drejtë plotësisht zotëri Çunaku për këtë sallë sepse është e palogjikshme, shembull unë ku jam ulur nuk mund të shoh asgjë atje në fillim, mirëpo ajo që unë deshta ta them është se duhet të ketë një bashkëpunim mes pozitës dhe opozitës për zhvillimin ekonomik të këtij vendi sepse kemi vetëm edhe 3 vite mandat e që shumë shpejt shkojnë e që pastaj askush nuk do të na përmend për njerëz të mirë nëse e lëm qytetin më keq se që ka qenë. Pra nëse me mendjemadhësi vazhdojmë duke "i'a gju topin" asgjë nuk arrijmë, normal ne jemi opozitë dhe kritikojmë për gjëra të ndryshme, mirëpo edhe këta që janë pozitë duhet ta gjejnë mënyrën e komunikimit me opozitën, jo arrogancën sepse nuk na dërgon ajo punë asnjëherë sepse shumë mirë jeni në dijeni se qysh i keni numrat e që 1 apo 2 numra e prishin gjithë balancën e Kuvendit Komunal e që sigurisht se nuk gjë e mirë, pra ky është mesazhi im dhe nuk kishte të bëjë me kritika apo gjëra të tilla ndaj asnjë subjekti politik.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, e respektoj mendimin, gjegjësisht frymën që dëshiron ta kultivoj kolegu këshilltar i Kuvendit z.Gazmend Islami, por sigurisht që u pa para rreth gjysmë ore kur u thirra në dy Rregullore të Kuvendit dhe kërkova bashkëpunimin për formimin e një komisioni i cili nuk di çfarë të fshehët nëse nuk ka defekte, që të votohet kundër e që e bënë opozita, andaj nuk mund të bashkëpunosh me dikë që shpenzon mbi 1 milion euro dhe nuk të lë të shikosh kush. Unë një ditë më parë edhe në mbledhjen e KPF e hapa këtë temë dhe pati diskutime duke u potencuar se kemi Rregullore, i kemi në ueb faqe të Komunës të publikuara e ku ta dijë unë, mirëpo në ueb faqe të Komunës nuk është e paraqitur certifikata familjare, pastaj nuk është afërsia e njerëzve (lidhja angnate lidhja kognate) dhe një komision i bazuar në rregullore të bënte monitorim dhe do t'i shihnim këto defekte u votu kundër, përse u votu kundër, sepse ka diçka për tu fsheh, prandaj nuk mund të ketë bashkëpunim.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, fillimisht dëshiroj të ndalem pak rreth dy propozimeve të kolegut z.Naim Çunaku të cilat nuk u votuan që të përfshihen në rend të ditës si pika shtesë për këtë mbledhje, vërtetë është për keqardhje sepse ishin dy propozime të cilat qesin në pah vetëm transparencën e qeverisjes lokale, të votohen kundër pa asnjë argument dhe pa asnjë arsye është vërtetë e dhimbshme për logjikën e qeverisjes së këtij Grupi qeveritarësh.

Sa i përket Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal si një prej dokumenteve më të rëndësishme të Komunës, unë pa dashur t'i përsërisë pikat e potencuara nga kolegët parafolës do të ndalem në një analizë të përgjithshme të këtij dokumenti. Për të ditë dhe për të analizuar diçka drejtë duhet të kuptohet fillimisht se çfarë jemi duke analizuar dhe për çfarë po flitet, pra kemi të bëjmë me një Strategji që në thelb është qasje e veçantë për arritjen e një qëllimi, do të thotë është një qasje dhe një mënyrë se qysh ne i qasemi punëve, qysh ne i qasemi resurseve për të shtruar një rrugë nëpër të cilën dëshirojmë të arrijmë deri te një cak, e për këtë kjo Strategji duhet të ketë një rrjedhë logjike dhe të përbëhet nga pikat dhe struktura e saj që duhet të përmbaj një dokument i tillë. Strategjia duhet të përmbaj qartë qëllimet dhe objektivat e saj të përcaktuara në kohë, pastaj të ketë të shkruara mënyrën se si do të arrihen ato, prandaj strategji se do të



arrihet qëllimi i caktuar dhe në fund t kemi vlerësimin e strategjisë. Si fillim kjo Strategji do të duhej të kishte një pjesë hyrëse, një paragraf që tregon lidhmërinë e saj me Strategjinë paraprake, Komuna e Podujevës ekziston që një kohë shumë të gjatë që ndoshta nuk dim as shumica prej neve këtu, prandaj nuk mundemi ne tani të ndërtojmë një strategji pa u kthyer në të kaluarën, nuk mundet një Strategji për vitet 2023-2025 të mos ketë harmonizim, të mos e ketë bazë dhe të mos e ketë vazhdimësi strategjinë paraprake, e që ky paragraf dhe kjo pjesë hyrëse i mungon këtij dokumenti. E them këtë për arsye se nga Strategjia e mëparshme ka projekte të cilat nuk janë përfunduar e që duhet të dihet përse nuk janë përfunduar dhe a do të vazhdojnë ato projekte, pastaj mund të ketë projekte që nuk kanë filluar fare e që nuk janë në strategjinë e re andaj duhet të dihet meqë kanë qenë në strategjinë e kaluar dhe tani nuk janë, përse nuk janë, pastaj ka projekte që kanë qenë në atë të kaluarën dhe nuk janë realizuar dhe tani janë sërish në Strategjinë e re andaj edhe për këtë do të duhej të kishte një analizë përse nuk janë realizuar ato projekte dhe tani sërish janë në strategjinë e re. Pra ky është ai paragrafi kryesor që do të duhej të fillonte Strategjia në mënyrë që të shtrohej rruga për tu përcaktuar pikat tjera dhe projektet tjera të hartimit të saj. Po ashtu si vërejtje tjera të kësaj strategjie janë që për projektet dhe objektivat që e kapërcejnë planifikimin buxhetor nuk është identifikuar burimi financiar se nga do të merren mjetet për tu realizuar këto projekte që kanë mungesë të buxhetit. Pastaj nuk janë specifikuar avantazhet konkurruese që është pikë shumë e rëndësishme e strategjisë e që ato avantazhe konkurruese do të duhej të përcaktoheshin në raport me Komunitat tjera sepse ne duhet të ndërtojmë strategji bazuar në ato që ne i kemi në raport me Komunitat tjera. Nuk ka analizë të kapaciteteve financiare dhe burimeve njerëzore për mundësitë teknike dhe financiare të realizimit të objektivave të saj. Nuk janë përditësuar të dhënat e sektorit privat, kur jemi në dijeni se sektori privat është “gjaku” i zhvillimit ekonomik dhe nuk kemi një përditësim me të dhëna të sakta mbi sektorin publik të Komunës tonë. Nuk ka informata për sektorët në rritje ekonomike në Komunën e Podujevës e që janë me potencial të theksuar në Komunën tonë siç janë bujqësia, tregtia dhe prodhimi. Sa i përket arsimit nuk ka informata të detajuara për gjendjen infrastrukturore për institucionet të Komunës siç janë kabinetet dhe sallat e sportit. Objektivat nuk janë të matshme, specifike, kohore dhe shpeshherë të paarritshme, çdo objektivë që parashihet në Strategji duhet t’i nënshtrohet këtij filtri e që objektivat duhet të jenë të matshme duhet të jenë specifike në kohë dhe të arritshme, e për të qenë të matshme specifikat duhet të jenë aspektet kohore, pra një objektivë mund të deklarohet si e arritshme apo jo vetëm kur e dimë çka duhet të arrihet, do të thotë duhet t’i kemi vlerat matëse nga aspekti financiar dhe vlerat kohore nga aspekti kohor se kur një objektivë duhet të arrihet dhe kur ajo është përmbushur. Po ashtu nuk janë prioritetizuar objektivat sipas rëndësisë së tyre në funksion të zhvillimit ekonomik e që çdo Komunë dhe çdo institucion i ka qëllimet e veta por ajo se çfarë i bënë të rëndësishëm apo jo është hierarkia e qëllimeve dhe objektivave sepse nuk mund të fillosh së implementuari të gjitha objektivat dhe qëllimet pa pasur një hierarki në bazë të rëndësisë dhe peshës së prioritetizimit të objektivave dhe qëllimeve që ka Strategjia dhe qeverisja lokale, si dhe së fundi, analiza e gjendjes momentale është e bazuar në të dhënat e vjetruara dhe nuk përkon me realitetin e që edhe kjo është një e metë e madhe që tregon se kjo Strategji është bërë si është bërë duke marrë copy paste nga Strategjitë tjera të bëra nga kompanitë tjera e që ndoshta edhe vetë përgjegjësit nuk janë të informuar dhe nuk ka si të jetë ndryshme, ndërsa për votim apo jo nuk diskutohet kjo çështje ashtu siç u potencua edhe më herët se Grupi i LDK-së është kundër kësaj Strategjie si dokument i cili i prinë zhvillimit për arsye se vet Strategjia në horizontin e saj e ka të ardhmen e Komunës dhe në bazë të kësaj vëhen kornizat dhe binarët se kah do të shkoj Komuna e pastaj të gjitha dokumentet tjera janë në funksion të kësaj Strategjie.

**z.Burim Hasani**, theksoi, do të doja ta di se që 20 vite a ka pasë ndonjë Strategji të zhvillimit Ekonomik që të mos i lëm investitorët dhe bizneset të ikin nga qyteti i Podujevës. Çfarë zhvillimi është bërë për 20 vite me radhë, a ka ndonjë dokument që e ka ndal një biznes ose një ndërtues, madje vetëm mund të shikoni në shumicën e pjesëve të Komunës së Prishtinës dhe Komunës së Fushë Kosovës një pjesë e

madhe e bizneseve dhe investitorëve Llapjan kanë ikur nga qyteti i Llapit, pse, a ka qenë Strategjia e mirë e Zhvillimit Ekonomik për 20 vite apo çfarë kundërshtimi. Për 20 vite radhazi do të thotë kanë ikur bizneset, investitorët dhe ndërtuesit e që mund të themi se kemi një pjesë të madhe të kompanive të ndërtimit në dy Komunat e cekura prej Beni Dona, Malësia Invest, shpëtimi Invest e të tjera dhe shumë kompani tjera si Lesna, Deshishku që janë kompani të Llapit por që kanë ikur, për çfarë arsye kanë ikur ata nga Llapi dhe kanë shkuar në Prishtinë dhe Fushë Kosovë, a kanë pasë këto dy Komuna ndonjë Strategji më të keqe apo më të mirë, kjo tregon përse kanë ikur investitorët, kurse unë po shohë shumë kritika dhe po më pëlqejnë shumë kritikata e tyre që për 20 vite ku kanë qenë këta që nuk i kanë kritikuar, kurse tani për 1, 2 apo 5 vite është problem t'i kthejmë ata investitor dhe ata ndërtues. Shikoni bizneset, investitorët, tregjet i kemi të mbushura me Llapjan si në Prishtinë si në Fushë Kosovë e mos të them se ka filluar një pjesë e madhe e tyre edhe në Komunën e Lipjanit dhe atë të Obiliqit.

Janë mbi 4 fabrika nga ana e Llapit të cilat janë të vendosura në rajonin e Obiliqit, ku është fabrika e bllokave-Apollonia, janë edhe tri pjesë të fabrikave ndërlidhëse njëra me metal punues tjetra me plastikë dhe me elektrikë të cilat janë të vendosura në Qytetin e Obiliqit përkatësisht në pjesën e Orloviqit, kështu që po të kishte ndonjë Strategji më të mirë besoj se bizneset nuk do të iknin nga Llapi. Pra Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 i ka disa ndryshime dhe është mirë të koordinohemi dhe ta përkrahim, përndryshe po të kishin qenë Strategjitë e mira edhe për vitet e kaluara besoj se Qyteti i Podujevës do të ishte më i zhvilluar, më i mirë dhe më i zhvilluar.

Unë vetë merrem me patundshmëri dhe më vie shumë keq që të gjithë investitorët e Llapit kanë ndërtuar në Fushë Kosovë, Prishtinë, Lipjan, kurse tani të na i merr investitorët edhe Obiliqi është shumë keq.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, në qoftë se e analizojmë dhe e lexojmë me kujdesë Strategjinë Zhvillimore Lokale 2023-2025 mund të shohim se ka disa referenca tek pjesa e analizës, pra referenca e parë nëse i referohemi shkruarit të kësaj Strategjie shkruhet Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2022, pastaj referenca tjetër është Plani Zhvillimor i Komunës së Podujevës 2016-2025.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, kolegu paraprak nga radhët e AAK-së (z.Burim Hasani) u mundua të na tregoj se tash së fundmi është pjesë e koalicionit me këtë fjalim, por ne e dimë atë, ndërsa sa i përket strategjisë dhe bashkëpunimit mund të them se bashkëpunim nga ne u kërkua pak më parë në hyrje të kësaj mbledhje e që kishte të bënte vetëm për transparencë të këtij Kuvendi me ato dy pikat e propozuara, andaj ku ishin ata që nuk treguan bashkëpunim në këtë pikë që për qëllim kishte vetëm ngritjen e transparencës, qoftë përmes një komisioni ad-hoc që të vlerësoj bursat dhe subvencionet, qoftë për pikën që ishte vetëm për transparencë transmetimi i seancave drejtpërdrejtë nga media private.

Sa i përket Strategjisë, jemi duke fol për Strategji dhe unë u mundova ta elaboroj në foltore atë pak a shumë atë por si duket nuk kanë qenë me vëmendje ose nuk kanë qenë këtu, pra Strategjia është diçka që parashihet tash e tutje, ndërsa ne jemi duke menduar dhe jemi të zgjedhur për diçka nëse nuk është mirë, ta bëjmë mirë, nëse është mirë si mund ta bëjmë edhe më mirë e jo të ndalemi dhe sërish ta "vajtojmë" të kaluarën, është bërë çfarë është bërë të gjithë e dimë sepse jemi këtu dhe jemi dëshmitar që janë bërë punë të mira, janë bërë punë të mëdha, por tani jemi këtu të zgjedhur për të parë dhe për të shtyrë procese përpara këtu e tutje, mirëpo nëse ndalemi dhe kthehemi nga e kaluara ajo është vetëm për tu shmang dhe ta devijuar vëmendjen nga e tashmja dhe e ardhmja si dhe mbulim i paaftësive.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani për tani nuk kemi të lajmëruar anëtar tjerë të Kuvendit për të marrë fjalën, mirëpo urdhëroni nëse ndokush nga Ekzekutivi dëshiron të jap sqarime dhe përgjigje.

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, pati pyetje dhe vërejtje të ndryshme nga kolegët parafolës rreth kësaj Strategjie, andaj kërkoj të jepen sqarimet dhe përgjigjet nga ana e Drejtorit të Drejtorisë përkatëse.

**z.Vigan Salihu**, drejtor i DPZHE, theksoi, nuk pati pyetje por vetëm u ngritën hipoteza të paqëndrueshme, si do qoftë ju falënderoj për kontributin e juaj dhe ju lus ta votoni këtë draft Strategji të Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 të Komunës së Podujevës.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, po e përsëriti edhe njëherë, nepse ndokush mendon të bisedoj për Strategji zhvillimore dhe të kthehet dhe shpëtim të gjejë veten te ndonjë gabim që mund ta gjen tek ndonjë qeverisje të mëparshme, vërtetë është, nuk po di me çfarë fjale ta them, por jo në nivel të përgjegjësisë. E di se çdo kush që punon dhe gabon, por nuk gabon vetëm ai që nuk punon asgjë sepse ai numëron vetëm atë që nuk punon. Mirëpo sot të përmendesh Strategji dhe të thuash që nuk pas, a ka pas apo nuk ka pasë, dokumentet e Komunës së Podujevës janë publike dhen kushdo që dëshiron të merret me ato i ka, por të ngritët dilemë duke pyetur a ka pas apo nuk ka pasë është diçka tjetër, po e tregon një nivel secili të vetin. Ndërsa për këtë formën që u tha se përse bizneset e Llapit kanë ikë prej Llapit, ai që ka logjikë ekonomike ai e dinë që biznesi në rend të parë është një operatorë ekonomik që mendon për tregun, mendon për fitimin e tij dhe mendon për kushtet të cilat 'iu kanë krijuar. A jam i kënaqur unë që si Podujevë nuk kemi zhvillim ekonomik tjetërfare, jo aspak nuk jam i kënaqur, por ë akuzosh në atë formë, jemi në dorën e lirë të ekonomisë së tregut dhe nuk jemi në atë gjendje se ku ta përcaktoj ndokujt Komuna se ku do të investoj. Edhe një gjë, para se ndokush të vlerësoj se çfarë ka ndodh para vitit 2000, më mirë është të shikoj dhe ta thotë çfarë ka ndodh nga vitit 2001 e këndeje në Kosovë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, meqë nuk ta lajmëruar për të marrën fjalën, atëherë e hedh në votim Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 e Komunës së Podujevës, sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 28 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent për momentin në sallë, me 19 vota Për, 9 vota Kundër dhe asnjë votë e përmbajtur, miratohet Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025 e Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.*

## **2. Propozim vendimi për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, jemi në dijeni se edhe paraprakisht ka qenë një Marrëveshje mes Komunës së Podujevës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame-Podujevë për subvencionimin e shpenzimeve të varrimit, Marrëveshje e cila është propozuar të vazhdohet, çështje të cilën e kemi debatuar edhe në mbledhjen e KPF-së një ditë më parë ku ka pasë edhe disa propozime që t'i shtohen këtij subvencionimi, andaj e hapi debatin Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, tani kur e kemi pikë të trajtimit në kuadër të rendit të ditës çështjen e vazhdimet të bashkëpunimit mes Komunës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame-KBI në Podujevë që Komuna të subvencionoj një pjesë të ceremonisë së varrimit e që kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së e që nuk pati kundërshtime dhe nuk e besoj se nuk do të ketë as sot. Lidhur me këtë ashtu siç e kam paraqitur një propozim shtesë në KPF të njëjtin do ta paraqes edhe sot në Kuvend duke u nisë nga fakti që në momentet më jo të këndshme që i ndodh një familjeje vijmë në një situatë ku e përjetojmë një rast goxha të ftohtë dhe e kam parë vetë dhe sigurisht jeni dëshmitar edhe ju që një prej shqetësimeve që ndodhin ato ditë të liga, edhe pse është vullnet i dikujt tjetër e që nuk po dëshiroj të hyjë në fe, pra është hapja e varrit të të ndjerit/ës dhe në këtë segment sigurisht të gjithë kemi dëgjuar apo e kemi përjetuar se është një shqetësim sepse në atë ditë është goxha e mundimshme të organizosh dhe të bësh hapjen e varrit, andaj në këtë qëllim unë në KPF propozova që kësaj çmimoreje të subvencionimit të varrimit t'i shtohet edhe hapja e varrit, në këtë rast nga kontraktuesi apo bashkëpunuesi që KBI. Pra është e vërtetë që askush nuk e ka kundërshtuar këtë mirëpo është diçka shtesë që neve dhe atyre mund të na shkaktoj telashe e që njerëzit po i'u ikin telasheve por kur dikush ik nga telasht dikush duhet ta ketë atë telashe e që në këtë rast telashja i mbetet atyre familjarëve që kanë vdekje, dhe në këtë drejtim u dakorduam që të gjitha Grupet, gjegjësisht si Kuvend që të zhvillojmë bisedime në asketin e gjetjes së mundësive që edhe këtë pjesë ta kontraktojmë

me KBI-në apo me ndonjë formë tjetër në mënyrë që të jetë lehtësim për qytetarët, pra kur e potencova të gjithë, normalisht se këtë e mbështesim të gjithë këtë që të gjejmë forma dhe mundësi që t'i marrim edhe si shërbim shtesë hapjen e varrit.

Ajo që dua ta theksoj sot e që një ditë më parë në KPF nuk e kam ditë është se kërkesa ose çmimorja e KBI ndryshon me atë që e kemi ne paravetës dhe nuk e di tani mos rastësisht po del ndonjë mos marrëveshje me KBI-në ngase totalin e shpenzimeve që e ka kërkuar KBI për këto shërbime të cilat i ka kryer deri më tani dhe synon t'i vazhdoj është 225€, ndërsa ne po diskutojmë për një shumë 200€, pra nëse ata kanë kërkuar 225€ kurse ne po miratojmë një shumë 200€ a po e konsiderojmë këtë çështje të kryer, unë besoj që jo sepse kemi diferencë mes shumave, apo do të duhej ta miratonim kërkesën fikse qysh e ka kërkuar KBI ngase ne po miratojmë kërkesën e KBI e cila ka kërkuar 225€ e jo 200€ siç po e shqyrtojmë ne për ta miratuar. Pra krejt këtë e them me qëllimin që të mos na del ndonjë kundërthënie mesa asaj çka ne po mundohemi të lehtësojmë e që pastaj mund të del ndonjë telashe që mund të na qoj në shkëputjen e këtij bashkëpunimi mes Komunës dhe KBI-Podujevë.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, edhe ne Grupi i anëtarëve të Kuvendit nga LVV e përkrahim propozim vendimin për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit për qytetarët me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës.

**z.Gazmend Islami**, theksoi, edhe unë e përkrahi këtë propozim vendim, por të merret parasysh edhe kërkesa e kolegut parafolës z.Naim Çunaku ngase mendoj se është shumë e rëndësishme që kur kryhet shërbimi është mirë të kryhet me të gjitha e jo shembull dikush tjetër të bënë hapjen e varrit kurse pjesën tjetër ta kryen dikush tjetër. Pra është një çështje e cila ndoshta do të duhej të bëhej edhe më herët sikurse që do të ishte mirë që të sqarohet edhe çmimi. Pra nëse miratohet sot të merret parasysh që në kuadër të çmimit, në kontratë të përfshihet edhe hapja e varrit dhe të gjitha çështjet tjera përkatëse.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSH, theksoi, kërkoj falje që fillimisht nuk e paraqita fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, mirëpo sigurisht kjo temë është diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së dhe janë shterr diskutimet sa i përket këtij propozim vendimi. Pajtohem plotësisht që ka hapësirë dhe ka vend për përmirësimin e çmimoreve duke marrë për bazë kërkesën e KBI-Podujevë e që edhe si propozim vendim është sjellë në bazë të kësaj kërkesë të KBI, qoftë edhe viteve të kaluara, dhe që tani i përfundon afati kësaj Marrëveshje që ka pasë Komuna me KBI, andaj është dashtë që të merremi tani me këtë çështje e që prej 195€ sa ka qenë me vendimin e fundit, mundësia e vetme buxhetore është të rritet shumë në 200€, edhe pse kërkesa e KBI është sjellë me një shumë prej 225€ ashtu siç e ceku këshilltari parafolës, mirëpo rreth mundësive tona buxhetore mund t'ju them se kjo ndarje bëhet nga kategoria subvencione dhe transfere dhe me vetë faktin që është subvencion i bie që ne si Komunë e subvencionojmë Këshillin e Bashkësisë Islame atëherë ne subvencionojmë me aq mjete buxhetore sa kemi mundësi, jo me qsa sa i kërkojnë ata ngase ata mund të kërkojnë edhe shumë më shumë, edhe pse e kam parasysh se as edhe ato 225€ që i kanë kërkuar nuk janë të mjaftueshme për shërbimet e varrimit, mirëpo tani për tani këto kanë qenë mundësitë buxhetore dhe këtë e them se kjo çështje bie në kuadër të DSHMS-së dhe e gjithë shuma e ndarë për subvencione që është 100,000.00€ në kuadër të kësaj drejtorie destinohet vetëm për këtë çështje. Sa i përket hapjes së varrit, vërtetë është një breng dhe shqetësim edhe i jon, mirëpo unë e potencova dhe po e përsërisë se edhe kjo çështje lidhet me mundësitë buxhetore edhe pse thënë të drejtën kjo çështje nuk është as kërkesë e KBI-së por është diskutim që është bërë në vazhdimësi mes neve, mirëpo në këtë aspekt mund të dalin edhe probleme tjera sepse hapja e varrit nuk është një proces i lehtë sikurse që janë këto tjerat që kryhen nga KBI-Podujevë, e them këtë sepse për hapjen e varrit sigurisht që duhet kontraktuar një kompani e të cilën duhet të diskutohet edhe njëherë me KBI-në se kush e kontraktton, dhe kjo duhet të bëhet para se ndoshta të sjellët sërish në Kuvend një propozim shtesë për plotësim ndryshim të këtij propozim vendimi sepse vullneti është për përfshirje edhe të hapjes së varrit por fillimisht duhet të

dakordohemi dhe të kjarhtësohemi se si do bëhet ajo, konkretisht që kompaninë për hapjen e varrit ta bëjë KBI apo Komuna, dhe në cilindo variant shuma buxhetore do të jetë goxha e lartë.

Pra për fund po e përsëris se këtë e kem si breng dhe jemi në diskutim me KBI-në dhe sigurisht se shpejt do të gjejmë forma që në kuadër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit të përfshihet edhe hapja e varrit.

Ajo që mund të them se është paksa shqetësuese e që e kam vërejtur edhe gjatë diskutimeve dhe takimeve të ndryshme me qytetarë është se qytetarët nuk janë mjaftueshëm të njoftuar rreth këtij vendimi, dhe ne tani po diskutojmë që KBI-në ta subvencionojmë edhe për hapjen e varrit përderisa si shqetësim qytetarë që po e ngrisë është se shumë qytetarë i bëjnë pagesat edhe vet, edhe pse ne ja bëjmë KBI-së duke u bazuar në këtë çmimore që e kemi paravetës, pse bëhet kjo sepse qytetarët nuk janë mjaftueshëm të njoftuar me këtë vendim, andaj unë sot ju ftoj që ta votojmë e që besoj se secili nga ju do ta votoni, por krahas votimit të merremi gjithsecili edhe me njoftimin e qytetarëve se një venim i tillë ekziston. E them këtë sepse ka shumë njerëz të cilët vijnë dhe deklarohen se e kanë bërë këtë apo atë pagesë, përderisa edhe ne si Komunë e bëjmë atë pagesë, pra kjo është më e rëndësishme se sa të mendojmë qysh tani në start ta përfshijmë edhe hapjen e varrit e që besoj se shpejt do ta përfshijmë edhe këtë (hapjen e varrit) gjithnjë në bashkëpunim dhe koordinim me KBI-në si njësi kërkuese e këtij subvencionit që ne sot po diskutojmë dhe që besoj se do t'ju ndajmë atyre, e që fatkeqësisht nuk kemi mund t'ju përbushim kërkesën prej 225€ por me ndonjë plotësim ndryshim në të ardhmen që do ta bëjmë sërish bashkërisht shpresoj se do ti detajojmë edhe gjërat tjera.

**z.Gazmend Islami**, theksoi, është mirë të detajohen gjërat e jo të paguhet dy herë për diçka, pra qytetari nuk është i informuar dhe tani të paguhet dy herë për të njëjtin shërbim, prandaj është mirë që Komuna të mendojë që përmes Televizionit lokal që është TV Llapi të sponsorizoj por edhe përmes rrjeteve sociale të bëjë njoftime për qytetarët në mënyrë që ata të jenë të informuar sepse ka raste të shumta që paguajnë dy herë. Sa i përket saktësisë së çmimit unë po e kuptoj se ndoshta nuk mjaftueshëm mjete buxhetore, por duhet të ketë dokumente të nënshkruara në atë proces, e jo të ndodh që të shkohet pastaj të thuhet ta zëmë se Komuna ka ndarë 195€ kurse janë ndarë 200€ dhe tani ku mbeten 50€, si shembull e mora këtë, pra duhet të qartësohen gjërat, prandaj e potencova se për t'i informuar qytetarët për 1 javë ta zëmë ku mund të shfaqet njoftimi i këtij vendimi disa herë në ditë, e që do të ishte për të mirën e qytetarëve.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, rreth asaj që drejtori parafolës e potencoj se paguhet dy herë një shërbim, kjo nuk ka mundësi të jetë ashtu, pra nuk ka mundësi të paguhet dy herë një shërbim dhe këtë e them nga përvoja që kemi pas raste. Proceduar është kjo, merret letra/dokumenti prej QKMF-së apo prej Spitalit me të cilin konstatohet se ka ndërruar jetë personi, atë dokument e dërgon në KBI dhe gjitha tjerat kryhen pastaj. Në varreza kushdo mund t'i jap sa të dojë mjetet buxhetore Hoxhës aty, mirëpo për ato shërbimet që janë të cekura në çmimore asnjëherë nuk paguhen dhe kjo nuk ka ndodh asnjëherë në Komunën e Podujevës. Sa i përket rritjes së subvencionit nga 195€ sa ka qenë në 200€, është rritje shumë e ulët sepse kërkesa e KBI është 225€ e që në 4 shërbime kanë kërkuar ngapak rritje diku 10€ diku 5€, andaj do të ishte mirë të plotësohej sepse nuk ja vlen për atë shumë të mos plotësohet kërkesa në tërësi.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, kemi hy në diçka që patjetër duhet të merremi sepse është e ndjeshme, më kujtohet në një fazë tjetër kur për herë të parë kemi marrë një vendim të tillë, e kam pasë një propozim në atë kohë e që tani dëshiroj ta bëjë sërish, palët kontraktuese në këtë rast Komuna dhe KBI pa dashur t'ju hedh faj ose t'i lavdëroj, por është një fenomen që po ndodh vazhdimisht qoftë tek ne qoftë gjithandej Kosovës, ditën më të rëndë të familjarëve ku i'u vdes ndokush nga Këshilli i Bashkësisë Islame në atë ditë në një formë kushtëzohet pagesa e anëtarësisë, dhe një dilemë e autoritetit komunal që bënë Marrëveshje me KBI-në ndoshta nuk e tepërt që edhe kjo temë të diskutohet sepse një ditë të rëndë të jetës të një qytetari ta kushtëzosh me pagesën e anëtarësisë kur këto shpenzime po i paguan Komuna, ai mund t'i shfrytëzojë 364 ditë tjera qoftë në emër të sensibilizimit qoftë për çështje tjera që ata mund t'i kenë në

format e tyre për ta mbledh anëtarësinë, por jo ta kushtëzoj në një fazë që atë shërbim që i'a jep qytetarit atë ditë, e ka të subvencionuar prej Komunës.

Sa i prehtë asaj që drejtori i DSHPMSH e potencoj se disa punë janë më të renda e disa tjera më të lehta, pajtohem se sakt ashtu është, mirëpo kur dëshirojmë ta ndihmojmë dikë ose ta subvencionojmë dikë dhe t'ia lehtësojmë jetën është mirë të bëjmë përpjekje që sa më shumë ta lehtësojmë, përndryshe ne e diskutuam edhe në KPF se as ata (KBI) nuk prodhojnë dërrasa dhe ato gjësendet tjera, por ose duhet ata të jenë autoritet kontraktues me ndonjë kompani ose fundja këtë ta bënë Komuna e që asgjë të keqe nuk ka.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSH, theksoi, në asnjë mënyrë nuk dëshiroj të keqkuptohem për atë që e potencova apo më duket se nuk kam qenë mjaftueshëm i qartë, nuk e potencova se kjo është faj i KBI-së dhe nuk i'a hedha fajin KBI-së në këtë rast. Pra po ndërlihem me atë që e potencuan dy parafolësit z.Gazmend Islami dhe z.Ekrem Rrahmani, KBI për ato mjete buxhetore që i merr është e vërtetë që e sjellë dëshminë paraprakisht, por unë e potencova se brenda kategorive të çmimoreve ka kategori që realisht qytetari e paguan, shembull, në pikën e parë të çmimoreve thuhet transporti i kufomës nga shtëpia deri te varrezat, ka plotë raste që kjo nuk bëhet nga KBI por bëhet nga vetë familjarët/qytetarët si banorë.

Mandej thuhet pastrimi i kufomës, ata e kanë për obligim sepse paguhen për këtë gjë, por që pagesa më e madhe e prej qytetarëve që bëhet është pastrimi i kufomës. Prandaj sërish po e përsërisë se nuk është faji i atyre por është faji jonë që nuk jemi mjaftueshëm të njoftuar me këtë. Sigurisht këto ndodhin si shkak se në ato momente të gjithë jemi në dijeni se kemi dhimbej për humbjen e familjarit e që ndoshta nuk merremi shumë këtë pjesë se çka po japim e çka bëjmë por vetëm dëshirojmë që ta kryejmë në mënyrën më të mirë ceremoninë e varrimit, prandaj e thash se është mirë të merremi të gjithë më shumë me njoftimin e qytetarëve rreth këtij vendimi, e që zotëri Islami e kërkoj që të bëhet sponsorizim mediatik, mirëpo unë po e them që është mirë edhe ne si zyrtar të bëjmë një shpërndarje apo bashkëbisedime me qytetarë e që shumë shpejt do të njoftoheshin qytetarët. Pra e thash se ajo çështje bëhet për shkak të dhimbjes së familjarëve e që ndoshta nuk dim çka po japim dhe çka po bëjmë, por në fakt janë mjete buxhetore që paguhen si shumë totale në KBI-së sepse nuk sjellën dëshmitë veç e veç për secilën kategori, pra n e sjellë dëshminë si total për një të vdekur dhe i'a ekzekutojmë pagesën varësisht numrit të të vdekurve, pra këtu është dallimi.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 33 vota Për nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, me rekomandim që DSHPMSH të zhvilloj konsultime të nevojshme në funksion të një zgjidhje sa më të mirë të mundshme të kësaj çështjeje.*

**z.Haki Rudari**, theksoi, duke parë që kemi edhe tri pika të rendit të ditës duke shtuar kësaj edhe pikën të ndryshme, kërkoj që të kemi një, pauzë rreth një orë dhe njëkohësisht falënderoj kolegët nga LDK që po më përkrahin në këtë propozim.

*Mbështetet nga të pranishmit propozimi për pauzë nga ora 11:50 deri në ora 13:00*

*Pas pauzës mbledhja vazhdon duke filluar në ora 13:25.*

*Kryesuesi i Kuvendit rihapi mbledhjen duke konstatuar kuorumin.*

*Të pranishëm në sallë ishin 34 anëtarë/e të Kuvendit (mungoi z.Demokrat Hodolli)*

*Gjithashtu e pranishme ishte edhe Nënkyetarja e Komunës znj.Marigonë Lahu, drejtorët e Drejtorive (Antoneta Ejupi-Drejtorja e Administratës DA; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla Uka-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE, Fatmir Rudari-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural)*

### **3. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kuorumi ekziston, të pranishëm jemi 34 anëtar/e të Kuvendit, andaj mund të vazhdojmë me punime sipas rendit të ditës aty ku kemi mbet, urdhëroni kush dëshiron fjalën.

**z.Florent Hasani**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim propozim vendimin për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023, propozim ky i nevojshëm dhe në interes për Komunën dhe qytetarët përmes së cilit pronat komunale vihen në funksion të afarizmit që sjellë të hyra edhe në buxhetin e Komunës.

Ky proces patjetër duhet të shkojë në përputhje të plotë me Ligjin përkatës dhe Rregulloren përkatëse e cila parasheh mënyrën se si këto prona mund të shfrytëzohen nga qytetarët.

**z.Valon Demolli**, theksoi, sa i përket Listës së pronave urojmë që të zbatohet pikë për pikë dhe të jepen sa më shumë prona në shfrytëzim e jo ashtu siç ndodhi gjatë këtyre viteve duke mos proceduar asnjë pronë për ta dhënë në shfrytëzim edhe përkundër faktit që këtë vit për këtë listë keni thirr mbledhje të jashtëzakonshme për ta miratuar me urgjencë dhe rezultati deri tani është i barabartë me zero.

Krahas kësaj si obligim ligjor kërkojmë listën e përgjithshme të pronave komunale edhe pse këtë e kemi kërkuar edhe më parë dhe na keni thënë se brenda muajit do ta publikojmë.

**znj.Saranda Stublla-Uka**, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, pra si pikë të rendit të ditës për këtë seancë kemi propozim vendimin për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023.

Për dallim prej listave tjera të mëparshme në këtë Listë janë paraqitur edhe destinimet sipas Hartës Zonale, prandaj i propozoj Kuvendit për miratim.

**z.Gazmend Islami**, theksoi, sa e kam lexuar këtë propozim vendim, dhe me sa dëgjova deri tani normal se të gjithë pajtohemi se pronat komunale duhet të jepen në shfrytëzim për shkak se është koha që ato prona të jepen në shfrytëzim në mënyrë që afaristët dhe njerëzit që dëshirojnë të investojnë në Komunën e Podujevës t’iu jepet mundësia dhe të mos mbesin gjitha ato prona të pashfrytëzuara, mirëpo të nderuar kolegë fillimisht kam kërkesë prej pozitës që të kenë mbështetjen edhe të opozitës, fjala është se unë e kam ngritur një problem shumë herët për 8 hektarë tokë që janë aty ku është hapur qendra tregtare “Park Plaza” e që askush deri më sot nuk po mund ta merr guximin të më mbështesë kur e dimë që ajo pronë atje shfrytëzohet nga biznesmen të ndryshëm por që nuk paguan asnjë cent as për Komunën tonë e as për qeverinë, pra ky është një lloj sfidimi, e që ne nuk jemi kundër investitorëve dhe nuk jemi që të mos ketë investime aq të bukura siç është bërë ajo qendër, mirëpo askush mbi ligjin dhe askush mbi shtetin, pra nuk mundet që një biznesmen të jetë më i fuqishëm se shteti, prandaj ndershmëria dhe serioziteti për çka i keni marrë votat është me mbrojt pronën publike dhe mendoj se Komuna duhet që sa më shpejtë, përkatësisht drejtoresha e Drejtorisë përkatëse duhet të merret me këtë problem, dhe ta sjellë në Kuvend se kush ka

bërë marrëveshje, si është bërë marrëveshja, kush është duke e shfrytëzuar atë hapësirë ku janë 8 hektarë tokë komunale që është kthyer në pronë të Komunës për çka kemi këtu prezent anëtar të Kuvendit të cilët kanë qenë edhe në atë kohë anëtar të Kuvendit, dhe të marrim këtu vendimin.

Nëse dikush mbron interesat e grupeve të caktuara, të dalin me emra, pra të gjithë ata që nuk e përkrahin interesin qytetarë dhe interesin e Komunës tonë tregojnë faktikisht se janë mbështetës të një klani i cili ka uzurpuar 8 hektarë tokë të Komunës së Podujevës. Këtë e kam faktuar sepse e kam mbledh gjithë dokumentacionin përkatës por fatkeqësisht atëherë ku ishte koha nuk erdhën disa prej anëtarëve të Kuvendit të na mbështesin dhe nuk është debatuar kjo çështje, por besoj se Drejtoresha e Drejtorisë përkatëse sepse e ka për obligim këtë edhe pse unë do t'i drejtohem edhe organeve më të larta siç janë gjykata dhe prokuroria për këtë temë dhe shpresoj se shumë shpejtë do ta dorëzoj lëndën atje ngase dikush duhet të arsyetohet përse aty është bërë ndërtimi kur nuk ka asnjë leje, kush ka dhënë leje dhe kush do që ka shkel ligjin e ka vendin në burg, prandaj të mos ikim prej këtyre temave duke thënë se nuk jemi ne për këto punë ngase dikush na ka votuar neve për t'i mbrojtur ata, dhe për këtë fakt e ka për obligim shefi i Grupit të LVV-së të dal në foltore dhe të jap mendimin e qartë të LVV-së, dhe pastaj të dalin edhe përfaqësuesit e subjekteve tjera (LDK, PDK, AAK) ta japin qëndrimin e tyre.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, një prej elementeve bazë dhe përgjegjësi të thelbësore të pushtetit lokal apo Komunës është ruajtja e pronës komunale dhe në vazhdim të këtij përcaktimi ligjor parafolësi z.Gazmend Islami në një formë ftoj të gjitha grupimet politike të deklarohen në foltore, jo që kemi obligim për këtë, por po e vërej se nuk kemi për çfarë të largohemi nga ajo, si dhe i përmenduri i thirr në disa prej anëtarëve të Kuvendit që kanë qenë edhe pjesë të asaj legjislature kur prona X është kthyer në pronë komunale e që unë i përkas asaj legjislature. E vërtetë e madhe është dhe që ende e kam në telefonin tim se çfarë kur kap diskutuar në atë kohë, çfarë diskutoj tani dhe në kontinuitet, dhe nuk mund të jem dhe të them tjetër diçka përveç asaj që e thotë ligji, pavarësisht grupeve, shkronjave dhe vështrimeve politike, konsistenca ime e vazhdueshme dhe është në përputhje të plotë me ligjshmërinë, me ligjet pozitive që janë, pavarësisht ndërrimit të pozitave që tani kemi ndërruar pozitë-opozitë e që edhe unë kam ndërruar qasje pozitë-opozitë mirëpo konsistenca në vendimmarrje ka qenë gjithmonë në interes të qytetarit dhe në këtë rast LDK e pa prononcim publik që gjithçka që është në përputhje me ligjin, dhe kjo që sot e kemi paravetës e që paksa rrëshqiti nga tema, mirëpo kur e kemi temën si pikë të rendit të ditës që ndërlidhet me dhënien në shfrytëzim të pronave komunale gjegjësisht aseteve komunale ashtu siç e përmendi kolegu nga radhët e LVV-së z.Florent Hasani, nuk mund të mos na gëzoj fakti se çdo aset komuna duhet të jetë në funksion të zhvillimit dhe përparimit të mirëqenies së qytetarëve dhe në këtë segment nuk kemi qenë asnjëherë të luhatshëm dhe jemi me vendim të prerë, por ku e kemi kundërshtinë tonë e që e kam thënë sigurisht në vitin 2003 dhe tani po e përsëriti në vitin 2022 që Komuna e ka për obligim parësor dhe ligjor që çdo pëllëmbë të territorit të vetë ta incizoi në çfarë gjendje është, si shfrytëzohet, sa vlen ose sa është kontributi i asaj prone në funksion të zhvillimit dhe mirëqenies së Komunës.

**z.Haki Rudari**, theksoi, kolegu nga Grupi jon politik LVV e paraqiti qëndrimin tonë e që realisht e përkrahim këtë propozim vendim për miratimin e Listës së veçantë të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2023, mirëpo ajo që dua të them rreth këtij propozim vendimi është në nenin 2 që realisht përmban arsyetimin e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik të Komunës, të dhënat kadastrale, qëllimin e dhënies në shfrytëzim, destinimin e pronës, parashikimin e kohës së publikimit dhe njoftimin e periudhave kohore si dhe shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe mendoj se kjo është në propozim vendim e që për ne është arsyetuar shumë mirë dhe pajtohem plotësisht andaj edhe qëndrojmë prapa këtij propozim vendimi.

Unë e kam edhe Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronave të paluajtshme të Komunës me nr.04/L-144 dhe në nenin 4 janë parimet e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, dhe më lejoni të lexoj disa prej tyre, 1-parimi i ligjshmërisë, 2-parimi i efikasitetit, 3-parimi i barabartë i trajtimit të palëve,



4-parimi i transparencës, 5-parimi i ruajtjes dhe interesit publik, 6-parimi i ruajtjes së vlerës së pronës publike. Prandaj për të mos ju marrë kohë më shumë Grupi i LVV-ës e përkrah këtë propozim vendim dhe në të njëjtën kohë i kemi edhe të gjitha parcelat dhe destinimin e tyre, andaj mendoj se gjithçka është në kuadër të ligjit dhe ne e përkrahim në tërësi propozim vendimin në fjalë.

**z.Bashkim Syla**, theksoi, ne Grupi i PDK-së jemi Për miratimin e këtij propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të Komunës të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2023.

Sa i përket pjesës tjetër mendojmë se është detyrë dhe përgjegjësi e Komunës të menaxhoj me pronat që janë nën përgjegjësinë e saj, kështu që nuk shohë arsye tjetër mirëpo do të doja të jetë më decidiv kolegu z.Gazmend Islami rreth çështjes së ngritur ngase sa jam në dijeni unë çështja e qendrës tregtare “Park Plaza” është në Gjykatë si lëndë, andaj nëse Gjykata ende nuk ka marrë ndonjë vendim, ne si Kuvend nuk e di se çfarë vendimi mund të marrim përveç kompetencave që ka Komuna në menaxhimin e pronës.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, të mos harrojmë se në seancën e kaluar ky Kuvend një pjesë të caktuar të asaj prone që po diskutohet për të r ka caktuar për ndërtimin e Stacionit të Autobusëve, dhe nga kjo që e përmendi parafolësi z.Bashkim Syla del se ne kemi marrë një vendim për një pronë që është në kontest gjyqësorë, në të vërtetë ju sepse ne nuk kemi qenë këtu.

**Kryesuesi i Kuvendit**, duke sqaruar çështjen e Vendimit që e ceku z.Naim Çunaku theksoi, Ministria përkatëse e ka kthyer shkresën vlerësuese përmes të cilës ka thënë se vendimi në fjalë është i ligjshëm ngase me Hartë Zonale dhe me Plan Zhvillimor të Komunës është i paraparë ndërtim, kështu që Stacioni i Autobusëve në atë pjesë do të ndërtohet pa problem dhe nuk ka kurrfarë problemesh ligjore, pra e them këtë ashtu siç jemi informuar përmes shkresës së Ministrisë përkatëse të cilën e ka përcjellë MPL për atë pjesë të pronës, ndërsa për pjesën tjetër nuk kam informata dhe nuk di çfarë të them.

**z.Gazmend Islami**, theksoi, nuk po dëshiroj të hyjmë më tutje rreth kësaj çështje sepse është debat i gjerë e që ndoshta në ndonjë mbledhje tjetër do ta trajtojmë, mirëpo unë për këtë çështje kam hulumtuar rreth 3 muaj, do të thotë nuk po foli veç fjalë koti, pra është një pronë komunale e cila i takon Komunës, ndërsa ajo që u tha se lënda për atë pronë është në Gjykatë është krejt për diçka tjetër dhe nuk ka të bëjë as me pronësi as asgjë tjetër sepse ajo është pronë komunale, është me numër kadastral dhe gjitha tjerat, mirëpo gjithë ajo që na duhet neve si Kuvend është të jemi bashkë dhe asnjë pëllëmbë pronë të Komunës asnjë personaliteti qoftë edhe nëse është ai kryetar i shtetit, ngase neve na mbron ligji dhe jemi të thirrur këtu që t'i mbrojmë të drejtat e qytetarëve, prandaj e thash që kjo temë është paksa më e gjatë dhe Kryesuesi i Kuvendit e ka lënë si pikë që mbledhja përkatëse do të thirret sërish ngase atëherë nuk kemi pasë kuorum e që besoj se do ta gjesh atë guxim dhe ta thirrësh vazhdimin e mbledhjes me atë pikë të rendit të ditës.

**z.Illir Koprani**, theksoi, pas këtyre polemikave që patën kolegët parafolës rreth pronës në fjalë se a është apo nuk është kontest gjyqësorë, do të doja prej Drejtoreshës së Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë e cila sigurisht se është e informuar dhe është në dijeni të na njoftoj për atë pjesë se a është vërtetë ndonjë kontest gjyqësorë, a është lënda në gjykatë apo jo.

**znj.Saranda Stublla-Uka**, theksoi, fillimisht po jap përgjigje sa i përket Listës së përgjithshme të pronave komunale që u parashtrua pyetje (nga z.Valon Demolli), pra Lista në fjalë është në finalizim dhe shumë shpejt do të publikohet. Gjithashtu sa i përket pyetjes se pse gjatë vitit 2022 nuk është dhënë asnjë pronë komunale në shfrytëzim, problem ka qenë Harta Zonale sepse nuk janë cekur destinimet për çka, por që në këtë Listë të pronave që është propozuar për vitin 2023 janë cekur edhe destinimet me Hartë Zonale se si do të jepen në shfrytëzim.

**z.Illir Koprani**, theksoi, edhe njëherë kërkoj prej Drejtoreshës parafolëse të na njoftoj se a është apo jo në kontest gjyqësor lënda për pronën të cilën u ngritë nga disa prej parafolësve.

**znj.Saranda Stublla-Uka**, theksoi, sa i përket kontestit gjyqësor është, mirëpo masë të sigurisë nuk ka e që në rast se do të kishte masë të sigurisë atëherë duhet të ndalohet çfarëdo veprimi, mirëpo edhe njëherë po e them se masë të sigurisë nuk ka.

Sa i përket pjesë së tjetër, janë disa objekte të cilat janë privatizuar prej AKP-së dhe që shfrytëzohen tani, pra në një formë mund të them se nuk është hyrë aty askush në mënyrë arbitrare.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e vë në votim këtë propozim vendim sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje me të vetmin ndryshim plotësim që është Lista e pronave e cila është rekomanduar me konstatimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur një ditë më parë, pra me thirrjen e kësaj mbledhje ju është dërguar një Listë tjetër, mirëpo në KPF ka hyrë një Listë tjetër e cila edhe është rekomanduar për shqyrtim dhe miratim.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent, me 28 vota Për, asnjë votë kundër dhe asnjë votë e përmbajtur (të tjerët nuk morën pjesë në votim), miratohet Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF-së e datës 08.12.2022 ku pjesë është Lista e plotësuar dhe ndryshuar dhe e rekomanduar nga KPF.*

#### **4. Rishqyrtimi i Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba Komunal**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, kjo Rregullore është miratuar në mbledhjen e kaluar dhe është përcjellë në Ministrinë e Pushtetit Lokal e cila e ka përcjellë nëpër Ministrinë tjera relevante dhe kemi disa vërejtje dhe njëkohësisht është kërkuar që brenda 30 ditëve të bëhet rishqyrtimi i saj, konkretisht të përmirësohet, mirëpo sipas konsultimeve që kemi pasë me Drejtorë të Drejtorive mundësi që brenda 30 ditëve kjo Rregullore të përmirësohet/harmonizohet nuk është e mundshme, kështu që për më shumë fjalën ja kaloj Drejtorit të DSHPMSh në emër të Ekzekutivit.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSh, theksoi, sa për sqarimin e juaj, Rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale është votuar nga Kuvendi i Komunën më 03.11.2022 dhe për këtë nuk ka kaluar në asketin e ligjshmërisë në disa prej Ministrive përkatëse për shkak se disa prej tyre kanë kërkuar që të bëhen disa përmirësime brenda saj, prandaj ne kërkojmë që të bëhet anulimi i kësaj Rregulloreje dhe njëkohësisht të mbetet në fuqi Rregullorja aktuale deri sa të procedohet në Kuvend Rregullorja e re me përmirësime dhe harmonizim sipas rekomandimeve të Ministrive përkatëse.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, sa i përket Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale, kjo po shihet i nderuar Kryesues se kur bëhet diçka me nguti dhe kur bëhet diçka pa u dhënë mundësia të zhvillohet debati dhe si rezultat i kësaj pastaj edhe kontestohet edhe ligjshmëria e saj.

Nuk më vie mirë që një dokument i cili ka implikim të drejtpërdrejt në buxhetin e Komunës gjegjësisht në të hyrat vetanake të kundërshtohet ligjshmëria e saj. Nuk kam pasë mundësinë të diskutoj për këtë Rregullore sepse dihet qysh është zhvilluar ajo seancë dhe si është miratuar kjo Rregullore, por një vërejtje që e bëra një ditë më parë në mbledhjen e KPF-së por e them edhe këtu sot, do të doja që taksat të gjejmë mundësi të zbuten sidomos për operatorët ekonomik sepse fundja plotë gojën po e kemi për ndihmë ndaj operatorëve ekonomik e që e shikuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomikë se sa operator ekonomik janë shuar, dhe krejt në fund du ta them një diçka që për ta parë seriozitetin e kësaj, jeni në dijeni se ka më shumë se dy vite që janë të ndaluara lojërat e fatit në Kosovë ndërsa në Rregulloren në fjalë që është miratuar në seancën e kaluar e keni taksuar edhe atë pjesë që ligjërisht është e ndaluar në Kosovë.

Si do që të jetë, ajo që e përmendi Drejtori parafolës z.Bahri Selimi, ne sot a duhet t'i marrim dy vendime apo të mos bëjmë sërish ndonjë gabim, vendimi i parë që të anulohet kjo rregullore, dhe vendimi tjetër që të mbetet në fuqi Rregullorja aktuale, pra a duhet t'i marrim dy vendime në mënyrë që të mos dalim në

kundërshtim pastaj, andaj ndoshta do të ishte mirë të merrej një vendim me të cilin pezullohet Rregullorja e re dhe vazhdon të zbatohet Rregullorja që ka qenë dhe që është aktualisht në fuqi.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSH, theksoi, nuk bëhet fjalë për pezullim e as për shfuqizim sepse kjo rregullore ende nuk ka hyrë në fuqi për shkak se jemi në dijeni se pas votimit të një akti në Kuvend është edhe procesi i vlerësimit të ligjshmërisë në Ministrinë e Pushtetit Lokal, prandaj kjo rregullore nuk është në fuqi ende, prandaj po kërkojmë anulim të asaj rregulloreje që është miratuar në mbledhjen e kaluar dhe vetvetiu kuptohet se mbetet në fuqi Rregullorja e vjetër përderisa kjo të bëhet e plotfuqishme.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, pa dashur të luajmë rolin e të mençurit këtu, mirëpo një praktikë që është me Ligjin për vetëqeverisje lokale jemi në dijeni se autoritet për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të Kuvendit të Komunës, edhe pse në disa seanca të kaluara pati një instancë tjetër që vendoste për Kuvendin mirëpo kaloj si kaloj ajo seancë, dhe sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale nëse një përgjigje nuk kthehet brenda 15 ditëve, për aktin përkatës është një pranim në heshtje, dhe nëse i referohemi kësaj atëherë pyes si qëndron çështje me Rregulloren për orarin e punës së bizneseve, sa është vonuar dhe cila Rregullore është në fuqi sot.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sa i përket Rregullores për orarin e punës së bizneseve është e vërtetë se është vonuar paksa vlerësimi i ligjshmërisë mirëpo tani pasi që është kthyer në rregull e njëjta është publikuar dhe ka hyrë në fuqi, pra me këtë çështje proceduar kanë përfunduar dhe tani është në fuqi dhe është çështje e përfunduar.

Parafolësi e potencoj decidivisht se nëse nuk kthehen përgjigjet për vendimet e Kuvendit brenda 15 ditëve, aktet përkatëse hyjnë në fuqi, kjo nuk po vlen, madje kam qenë në disa takime por kanë qenë edhe zyrtar të Zyrës ligjore, dhe vazhdimisht na thuhet se pa u kthyer përgjigjet aktet e Kuvendit të mos publikohen.

Ka rreth 7-8 muaj që e kemi marrë një vendim për ndarjen e 70,000.00€ për ndihmë rasteve sociale – ekonomike, dhe kam kërkuar ta publikoj dhe të hynë në fuqi por nuk na është lejuar, pra Ligji për vetëqeverisje lokale është në fuqi mirëpo me një Udhëzim Administrativ ndalohet tani ashtu siç ka qenë që aktet për të cilat nuk kthehen përgjigje brenda 15 ditëve ato hyjnë në fuqi.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, ne mund të themi ashtu siç dëshirojmë, qoftë Udhëzim Administrativ qoftë të tjera, mirëpo ai që kupton në këto çështje sigurisht e dinë edhe që nuk mund të ketë asnjë Udhëzim e as rregullore që mund të jetë në kundërshtim me ligjin. Ligji për vetëqeverisje lokale nuk ka ndryshuar edhe pse ka hyrë në procedura mirëpo për shkak se duhen 2/3 e votave të minoriteteve sepse është pjesë e pakos së Ahtisarit, prandaj të thuhet sot, më kanë thënë, siç e potencoj Kryesuesi, nuk mund ta pranoj sepse po ai Ligj që ka qenë është edhe tani dhe atij duhet ti referohemi dhe përmbahemi.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, për këtë qëllim janë nxjerrë edhe Udhëzimet Administrative për ta plotësuar Ligjin në fjalë, dhe kjo po ndodh. Nuk jam i interesuar të debatoj me askënd rreth kësaj çështje sepse nuk kam diçka kundër, mirëpo mua nuk po më lejohet t'i publikoj pas 15 ditëve aktet të cilat nuk ka një vlerësim të ligjshmërisë nga ana e Ministrive përkatëse.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar Kryesuesi i Kuvendit, me gjithë mirëkuptimin për ty sepse nuk është në domenin tuaj, mirëpo të më thuash ti se për atë është Udhëzimi Administrativ, për mua është sikur të më thoni “gjeografikisht, trigllavi është në gjevxheli” e që këtë nuk mund të përbijë sepse nuk mund të ketë Udhëzim Administrativ ose Rregullore që mund të jetë në kundërshtim me Ligjin.

Çdo gjë është burimore, Kushtetuta, Ligjet, Rregulloret, Udhëzimet, pra kjo është ABC-ja.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim anulimin e Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale deri në nxjerrjen e një rregulloreje të re, përkatësisht harmonizimit sipas rekomandimeve të Ministrive përkatëse, ndërsa mbetet në fuqi Rregullorja e vjetër e cila edhe aktualisht zbatohet.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent, me 19 vota Për, asnjë votë kundër dhe asnjë votë e përmbajtur (të tjerët nuk morën pjesë në votim), merret vendim për anulimin e Rregullores nr.prot.01-431/03-0093814/22 për taksa tarifa dhe gjoha komunale, e miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 03 nëntor 2022 dhe që Ekzekutivi i Komunës, përkatësisht Drejtoritë dhe sektorët përkatës të fillojnë me përgatitjet e draftit të ri sipas vlerësimeve dhe rekomandimeve të Ministrive si dhe konsultimeve paraprake, anulim ky i cili është bërë për arsye se disa prej Ministrave të linjës kanë vlerësuar se akti në fjalë nuk është në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe duke kërkuar harmonizimin e të njëjtës sipas rekomandimeve përkatëse, mirëpo meqë nga Komuna është vlerësuar se për harmonizimin e aktit kërkohet punë, angazhim dhe koordinim me Ministrinë e linjës, e që kjo nuk mund të bëhet brenda një kohe të shkurtër, e njëjta anulohet dhe njëkohësisht kërkohet ri draftimin sipas rekomandimeve të Ministrive përkatëse.*

## **5. Rishqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për koordinimin e procesit dhe zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin Komunës së Podujevës**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendi,** theksoi, edhe për këtë kemi një vlerësim të ligjshmërisë nga ana e Ministria së Pushtetit Lokal sipas të cilit është thënë që në këtë komision duhet të përfshihen subjektet e ndryshme politike. Unë e kam edhe shkresën e Ministrisë dhe po e lexoj, Kuvendi i Komunës së Podujevës në vazhdimin e mbledhjes mbajtur më 07.11.2022 ka miratuar vendimin nr.01-020/-04-0093836/22 për formimin e Komisionit për koordinimin e procesit dhe zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin Komunës së Podujevës.

Ministria e Pushteti Lokal konstaton se vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, bazuar në nenin 12 të Ligjit nr.03/L-040 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ndërlidhur me nenin 5.2 të Udhëzimit Administrativ të MAPL nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane, i cili thekson se komisioni në fjalë duhet t'i ketë 7 anëtarë, përbërja duhet të jetë 4 anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjekte të ndryshme politike, 1 anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, 1 anëtarë nga Shoqëria Civile dhe 1 përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal. Pra ky është vlerësimi i ligjshmërisë nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokal.

**z.Naim Çunaku,** theksoi, nëse këtu jemi për të kontribuar për një çështje e cila është e një rëndësie të veçantë për funksionimin e Komunës, gjegjësisht për një afrim sa më të madh të qytetarëve në vendimmarrje e që një demokraci e zhvilluar është që sa më shumë ta ofroj qytetarin në vendimmarrje dhe që në këtë aspekt legjislatura në fuqi dhe kahja e zhvillimit demokratik të pushteteve lokale i ka dhënë rëndësi të veçantë formimit dhe konstituimit të këshillave të fshatrave.

Pa hyrë në atë që faktikisht jemi keq në këtë aspekt dhe kemi pritur që të bëhet diçka në këtë aspekt në mënyrë që të avancoj në këtë aspekt, dhe kjo që ndodhi e që e patëm edhe diskutim në mbledhjen e KPF-së se tentimi që para opinionit publik dhe para medimeve të caktuara me plotë fjalë se jemi për bashkëpunim dhe për ndërtimin e një qeverisje pa theksuar në masë që e pengon qeverisjen e mirë konfrontimet politike, neve na ndodhi që në seancën e kaluar..., unë nuk mund ta kuptoj se për një vendim i cili është kthyer jo i ligjshëm dhe të mos merakosemi ta paktën ata që e kanë votuar këtë vendim e që po i bie se kanë votuar në mënyrë të kundërligjshme, dhe të mos kenë interes për ta kthyer në formë ligjore, më bën paksa të çuditëm edhe pse nuk është për tu çuditur sepse po të ishte një përkushtim tjetër nuk do të ndodhte kjo.

Forma se qysh Kryesuesi i Kuvendit e paraqiti këtë çështje, nuk na njoftoj se mbi cilën bazë Ministria e Pushtetit Lokal e ka kundërshtuar këtë vendim, a është mos përfaqësimi i ndonjë partie politike, a është ndonjë propozim nga Ekzekutivi që nuk është dashtë të vinte e që e ka propozuar dikush nga Kuvendi i Komunës, dhe a do të thotë se ne sot jemi në pikën zero sa i përket formimit të komisionit për përcjelljen e punëve për ndërtimin e këshillave lokale, pra a jemi këtu në pikën zero i nderuar Kryesues, apo vetëm po e anulojmë sikurse atë paraprakisht por që për këtë nuk kemi diçka tjetër që vazhdon.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sa për sqarim, Ministria përkatëse e ka sqaruar në shkresë shumë mirë se për çfarë kthehet në rishqyrtim ky vendim, dhe atë pjesë jua lexova. Për më shumë po e vërej Drejtoreshën e Drejtorisë së Administratës e cila dëshiron fjalën për sqarime shtesë.

**znj. Antoneta Ejupi**, drejtoresh e DA, theksoi, nëse bënë një elaborim lidhur me situatën e krijuar, pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të rregullores për organizmin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra vendbanime dhe lagje urbane në Komunën e Podujevës, Kuvendi i komunës në vazhdimin e seancës më datë 07.11.2022 ka miratuar vendimin për themelimin e komisionit për koordinimin e procesit zgjedhor të këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, me ç'rast ky komision përbëhet nga 7 anëtarë, prej të cilëve 1 anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, 4 anëtarë nga subjekte të ndryshme politike, 1 anëtar nga Shoqëria Civile dhe 1 anëtar përfaqësues i fshatit apo vendbanimit ku do të bëhet zgjedhja e këshillit lokal. Në bazë të dispozitave ligjore Komuna e Podujevës vendimin në fjalë e ka dërguar në Ministrinë përkatëse për shqyrtim administrativ/vlerësim të ligjshmërisë, e që vendimi në fjalë është kthyer si i kundërligjshëm për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore konkretisht Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane, si dhe në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 2 të Rregullores komunale për bashkëpunimin e Komunës së Podujevës me fshatra vendbanime dhe lagje urbane.

Do të thotë vendimi në fjalë është kthyer i kundërligjshëm vetëm sa i përket subjekteve politike sepse 4 anëtarët nga radhët e Kuvendit të Komunës duhet të jenë të përfaqësuar nga subjekte të ndryshme politike, pra vendimi nuk kthehet në pikën zero mirëpo duhet të zgjedhet vetëm çështja e anëtarëve të komisionit nga radhët e Kuvendit të Komunës.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, Kryesuesi i Kuvendit nuk ishte i kuartë se ku jemi me vendimin në fjalë, mirëpo vetëm deshta edhe një plotësim, këta 4 anëtarë nga radhët e Kuvendit nuk e di përse nuk na u lexuan emrat se kush janë dhe nga cilat subjekte janë e që faktikisht për këtë çështje edhe vendimi është vlerësuar si i kundërligjshëm. Nuk po dëshiroj që tani ta luaj rolin sikurse nuk e di çfarë ka ndodh sepse e dim të gjithë, madje edhe në mbledhjen e KPF-së Kryesuesi i Kuvendit disa herë u mundua ta elaboroj duke thënë se di përse na është kthyer në këtë formë, ne jemi 5 subjekte në Kuvend kurse duhet të jenë vetëm 4 anëtarë e që 1 duhet të jetë i pa përfaqësuar sepse nuk mund të përfaqësohen të gjithë, dhe e vërejtja vullnetin e subjektit të dytë më të madh në këtë Kuvend që votoi kundër rishqyrtimit të këtij vendimi, dhe pa dashur të jem paragjykses, aty u pa gatishmëria e tyre që LDK me 14 anëtarë të Kuvendit të mos jetë e përfaqësuar. Nga ajo përbërje e Kuvendit që është kthyer vendimi i kundërligjshëm është 1 anëtar i AAK-së, janë 2 të LVV-së dhe 1 nga PDK, andaj kur pyeta disa herë se tani a jemi në pikën zero dhe a kemi të drejtë ne si LDK apo do të luhet loja përjashtuese sërish që ta kemi përfaqësuesin tonë në këtë komision apo do të vazhdojmë sërish me ankesa ngase vërtetë ne e kemi bërë një ankesë përmes të cilës e kemi kontestuar ligjshmërinë e atij vendimi e që po shihet se kemi pasë të drejtë, prandaj a do ta vazhdojmë sërish atë lojë apo do ta kemi të drejtën ne si LDK ta kemi përfaqësuesin në atë komision dhe të ketë propozimin, nëse fillojmë nga pika zero mund ta fillojmë me propozime të reja për 4 anëtar të Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, duke i'u drejtuar parafolësit z.Naim Çunaku, theksoi, ju e dini arsyen përse nuk jeni përfshirë në këtë komision, mbledhja atë ditë është caktuar në ora 17:00 dhe keni qenë të ftuar në atë mbledhje sikur krejt tjerët, qoftë përmes e-mailit qoftë përmes telefonit që e kam thirr shëfën e Grupit t'juaj z.Valon Demolli mirëpo nuk ka pasë gatishmëri për pjesëmarrje në atë mbledhje.

Kjo përse është kthyer në Kuvend për rishqyrtim është për t'u diskutuar sërish dhe ne jemi të obliguar që për çdo vendim i cili kthehet për rishqyrtim në Kuvend ta rishqyrtojmë sepse kjo është sipas ligjit dhe kështu kemi vepruar, ndërsa tani në debat/rishqyrtim dhe rezultatin nuk mund ta parashikoj, mirëpo në bazë të debateve që do të zhvillohen do të sjellim edhe një përfundim.

**z.Haki Rudari**, theksoi, është mirë të respektohet Rregullorja e punës së Kuvendit i nderuar Kryesues, nuk ka të drejtë të diskutoj X personi për të njëjtën pikë të rendit të ditës për pa u shterë diskutimet e anëtarëve të tjerë. Çështja tjetër, vendimet e MAPL-së qofshin ato pozitive apo negative për ne si Grup i LVV-së janë të pranueshme, edhe kur jemi mirë edhe kur jemi keq.

Kuvendi i Komunës në seancën e fundit ka formuar një komision ashtu edhe qysh e potencoj drejtoresha e DA-së, prej 7 anëtarëve prej tyre 4 anëtarë nga Kuvendi i Komunës, dhe unë kam një kopje të shkresës së MAPL-së-Njësia për administrimin e dokumenteve, dhe në këtë kopje të shkresës shkruan se akti në fjalë nuk është harmoni me dispozitat ligjore në fuqi, krejt në rregull është, prandaj në atë përbërje LVV ka dy anëtarë dhe ne si Grup i LVV-së e tërheqim njërin anëtar e që në këtë rast është znj.Drita Pajaziti e cila ka shpreh dëshirë vullnetarisht të tërhiqet dhe lëshon hapësirë për propozimin e anëtarit nga radhët e kolegëve të LDK-së. Mendoj se Rregulloret dhe Ligjet janë të njëjta për të gjitha subjektet politike prandaj edhe është mirë të veprojmë sipas tyre edhe kur na bie mirë edhe kur na bie keq.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se nuk kemi çfarë të diskutojmë më rreth kësaj çështje, andaj kërkojmë nga Grupi i LDK-së që të paraqet propozimin e anëtarit të tyre për anëtar në kuadër të komisionit në fjalë. Pra kalojmë në propozim konkret.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, më bëri ta marrë fjalën kolegu parafolës z.Haki Rudari, mirëpo jemi dëshmitar se një ditë më parë ka ndodh ajo në mbledhjen e KPF-së. Kur e kemi pasë këtë shqetësim përse LDK si Grupi më i madh politikë në këtë përbërje të Kuvendit nuk ka anëtar në komisionin përkatës dhe kur është votuar që kjo pikë t'i rekomandohet Kuvendit për rishqyrtim, Grupi i LVV-së ka qenë kundër që as në Kuvend të mos vie dhe ky është një realitet, mirëpo pavarësisht kësaj i falënderoj që kanë evoluar dhe e kanë parë se duhet të jetë edhe anëtar nga radhët e LDK-së, prandaj për këtë gjest i falënderoj, por dje ka qenë një disponim krejt tjetër.

**z.Haki Rudari**, theksoi, unë e respektoj kolegun parafolës dhe atë vetëm për moshën që ka. Çështja tjetër është se ne jemi parti të ndryshme politike si dhe çështja tjetër që ja vlen të theksohet është se nuk është e vërtetë që LVV dje në KPF ka votuar kundër, ne kemi abstenuar andaj nuk është njëjtë sikur abstenimi si vota kundër. Janë tri forma të votimit nëse ndokush nuk e dinë, Për, Kundër dhe Abstenim, dh ne kemi abstenuar, kurse nëse nuk është kështu kërkojeni nga zyra që ka mbajtur procesverbalin.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, gjeje ndonjërin prej anëtarëve që ka qenë prezent në atë mbledhje, të paktën vetëm një i cili del dhe e tregon të vërtetën se a është qysh po e them unë apo qysh po e thua ti.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, konsideroj se nuk jemi këtu para gjykatës për t'i dhënë përgjigje secilit, po është procesverbali që është mbajtur dhe i cili sigurisht sjellët në mbledhjen e radhës dhe atëherë mund ta konstatojmë këtë çështje, andaj të mos dalim jashtë temës.

**z.Gazmend Islami**, theksoi, kur e potencova më parë se për çështje që janë në të mirë të vendit pozitë e opozitë duhet të jenë bashkë, pothuajse gjysma e parafolëseve më kritikuan përse po e them atë, tani vetëm mund t'i shikoni inatet mes vete që u zhvilluan dhe që nuk ka njeri që i rehaton të jenë bashkë për një qëllim. z.Haki Rudari e potencon se ka abstenuar, po çfarë ka rëndësi kjo vota abstenim e që për mendimin tim ajo votë është kundër andaj të mos bëhet shaka. Ka përfunduar ajo çështje, vendimi në fjalë është kthyer nga Ministria e që nuk është mirë të kthehet në këtë formë një vendim i Kuvendit si shkelje e Ligjit, prandaj të kalohet kjo problematikë dhe të vazhdohet tutje, e jo të vazhdohet duke replikuar mes vete, më ka votuar, nuk më ka votuar, jo për, jo abstenim, sepse nuk ecet përpara me këtë qasje dhe me këtë debat.

**znj. Arnisa Sylejmani**, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së e propozojmë z. Ekrem Rrahmanin për anëtar në kuadër të përbërjes së Komisionit përkatës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pra tani çështjet i kemi të qarta dhe e hedh në votim propozimin që z. Ekrem Rrahmani të jetë anëtar në kundër të përbërjes së Komisionit për formimin e komisionit për koordinimin e procesit dhe zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin Komunës së Podujevës, përkatësisht rishqyrtimin e vendimit përkatës sipas rekomandimeve të MAPL-së. Pra i propozuari z. Ekrem Rrahmani zëvendëson ish anëtarin znj. Drita Pajaziti kurse pjesa tjetër e komisionit përkatës mbetet e pandryshuar.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent, me 24 vota Për, asnjë votë kundër dhe 2 vota të Përmbajtura (të tjerët nuk morën pjesë në votim), në procedurën e rishqyrtimit, miratohet vendimi për formimin e komisionit për koordinimin e procesit dhe zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin Komunës së Podujevës, përkatësisht znj. Drita Pajaziti zëvendësohet me z. Ekrem Rrahmani, ndërsa pjesët tjera të vendimit të mëparshëm nuk ndryshohen*

*Kryesuesi i Kuvendit konstaton se Komisioni në fjalë formohet në këtë përbërje:*

*-Ardi Hasani, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës-LVV*

*-Ekrem Rrahmani, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës-LDK*

*-Mimoza Abdullahu, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës-PDK*

*-Burim Hasani, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës-AAK*

*-Antoneta Ejupi, anëtar nga radhët e Ekzekutivit të Komunës*

*-Bleona Rama, anëtar nga radhët e Shoqërisë civile*

*-Anëtar/e përfaqësues nga këshilli i fshatit, vendbanimit, lagjes urbane, i cili propozohet dhe zgjedhet me shumicë të votave nga të pranishmit në tubimin zgjedhor të Këshillit përkatës.*

## 6. Të ndryshme

**znj. Arnisa Sylejmani**, theksoi, kam pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, fjala është për këtë pjesë të rrugës që po e shihni në foto (prezanton një foto të rrugës përkatëse) është fillimi i rrugës “Haxhi Sadri Blaku” në Podujevë, pjesë e cila qysh në verë është rregulluar por që hiq më larg se pas 1 jave ka filluar të dëmtohet, (e kjo me siguri prej kualitetit të lartë të punimeve).

Frekuentimi i veturave në këtë rrugë është shumë i lartë dhe ikja prej pjesës së dëmtuar mund të na vë në situatë ku mund të ketë aksidente, andaj kur mendohet të rregullohet ajo pjesë edhe pse premtimi për tu rregulluar shumë shpejt është dhënë, madje madje është thënë se do të rregullohet brenda 3 ditësh.

Kryesuesi i Kuvendit, bëri thirrje të mbahet qetësia dhe të dëgjohen diskutuesit në këtë pikë të rendit të ditës për të cilën tha se është mjaft e rëndësishme sepse ka pyetje, ka çështje të ndryshme që mund të ngritën, prandaj të mbahet disiplina sepse disa prej drejtorëve të Drejtorive i kemi këtu prezent e që mund të japin përgjigje dhe sqarime të nevojshme.

**z. Ekrem Rrahmani**, theksoi, ka 3 pyetje që dua t’i paraqes, dhe atë:

1-Lumenjtë, e kam përcjellë çështjen e tenderimit ku më 31 maj 2022 kanë dal 2 tenderë me 2 loto e që janë mbi 209,000.00€ për zgjerimin e lumenjve dhe prockave, por që nuk kam hasë askund se ku janë duke punuar, madje kjo u vërejt edhe para 2-3 jave kur patëm vërshime.

2-Stacioni i Autobusëve, çështje për të cilën nuk e di përse po punohet mbrapsht dhe këtë e them duke marrë parasysh se më 27 gusht 2022 ka dalë në tender rregullimi i Stacionit të Autobusëve, në muajin nëntor është sjellë në Kuvend propozimi për votim të parcelës si vend për ndërtimin e Stacionit të

Autobusëve, prandaj pyes si mund që fillimisht të qitet në tender për tu ndërtuar e pastaj të sjellët në Kuvend ndarja e pronës, do të thotë keni qenë në dijeni se janë votat apo përse kjo punë mbrapsht kështu. 3-Tenderët për shkolla, që ky drejtori i Drejtorisë së Arsimit i cili ka pas nga 2-3 drejtori sa ka qenë tek ne, e që shembull po të hyjmë dhe t'i shikojmë specifikat ka publikuar tenderin për renovim të shkollave, 5 loto, dhe për t'i ndërruar dyert brenda klasëve e ka vë si kusht me pasë lugë ngarkuese 3 ton, kamion kiper 5 ton dhe kamion kiper 10 ton, për t'ia dhënë tenderin për ta ndërruar në një shkollë një derë 575.5 €, andaj nuk e di përse duhet ta ketë kamion me 5 dhe 10 ton dhe lugë ngarkuese për ta ndërruar një derë, për t'ia rregulluar çmimin ndokujt apo përse.

**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, fjala është për rrugën “Skënderbeu” e cila si projekt është mjaft i rëndësishëm për Komunën tonë dhe duke e ditë edhe rëndësinë e tij kur e kemi votuar si projekt ka qenë zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës, projekt i cili arrin vlerën rreth 1.4 milion euro. Shqetësuese është ecuria e punimeve dhe sa kam njohuri ajo rrugë nuk është zgjeruar madje është në gjendja ndoshta edhe më e ngushtë se ka qenë e që do të thotë se nuk i kontribuon asgjë zgjidhjes së problemit të komunikacionit në Komunën e Podujevës si dhe është mjaftë shqetësuese që punimet janë duke shkuar tepër ngadalë. Pra ajo çfarë kemi vërejtur gjatë gjithë kohës në atë rrugë është bërë vetëm ndërtimi i kanalizimit dhe asgjë tjetër e re në atë rrugë.

**znj.Arjeta Abazi**, theksoi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, sa i përket për ngrohje nëpër shkollat e Podujevës deri së voni e dimë se kanë pasë problem me furnizim me lëndë djegëse për ngrohje, andaj pyetja është se a është zgjidhë problemi, përkatësisht a keni lidhë kontratë me ndokënd për furnizim me lëndë djegëse për të gjitha shkollat e Podujevës, nëse po, sa për transparencë do të doja ta shohë kontratës ngase kemi informacione që shkollat janë furnizuar me lëndë djegëse për ngrohje, por pa u lidhë kontrata, e që do të ishte diçka e jashtëligjshme.

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, po bëhen po thujse dy vite nga dëmtimi i rrugës kryesore që e lidhë fshatin Dumnicë e Poshtme me Qytetin e Podujevës dhe fshatrat përreth, vitin e kaluar edhe këtë vit janë ndarë mijëra euro nga buxheti i Komunës për asfaltimin e rrugëve por asnjëherë nga ky Ekzekutiv që dy vite nuk i ka shkuar në mendje që ta rregulloj këtë rrugë. Kjo është gjendja e rrugës Dumnicë e Poshtme-Podujevë (prezanton foto), andaj ju lus që ta rregulloni këtë rrugë e ti lëni asfaltimet e rrugëve deri në oborret e aktivistëve tuaj sepse gjendja e kësaj rruge është e keqe dhe si pasojë e saj mund të ndodhin aksidente me fatalitet për shkak të anashkalimit të saj.

**znj.Edona Shabani**, theksoi, dua t'ia rikujtoj edhe njëherë drejtorit të DSHPMSH-së rrugën që e kam cek edhe më parë dhe i them se prapë përmes emailit do ia përcjellë gjendjen e saj.

**znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, gjithashtu kam një pyetje për drejtorin e DKA-së, kam një informatë që në shkollën e fshatit Pollatë fusha sportive e asaj shkolle është duke u përdorur për parking, lidhur me këtë dua ta di nga drejtori se a ka ndonjë informatë dhe për çfarë arsye qoftë prindërit apo profesorët e shfrytëzojnë atë fushë sportive për parking, këto janë pamjet që i kam marrë prej shkollës së fshatit Pollatë (prezanton me foto), kështu që e pyes drejtori se për çka shfrytëzohet ajo fushë si parking dhe për cilën arsye sepse po dëmtohet ajo fushë sportive.

**z.Adnan Zymeri**, theksoi, kam informacion se në fshatin Bajçinë fusha sportive që është ndërtuar nga DKRS-ja është duke u dëmtuar nga disa qytetarë të atij lokaliteti që po i vendosin mjetet e tyre bujqësore në këtë fushë dhe po i pamundësojnë zhvillimet e aktiviteteve sportive të banorëve të fshatit. Mendoj se të gjitha investimet e bëra duhet të kenë mbikëqyrje për punimet dhe destinimet e atyre fushave sportive.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kam një pyetje për drejtorët e Drejtorive, këtë po ua them sepse më ka brengosur fakti që fusha sportive në fshatin Kërpimeh, fushë kjo e cila ishte keqpërdorur shumë dhe është në një gjendje jo të mirë për faktin se ishin dëmtuar rrethojat. Të gjithë ne e dimë se fshati Kërpimeh kohë më parë ka pas një klub të futbollit i cili ka qenë në një rang me KF Llapin dhe në atë fushë sportive



gjithherë ka pas aktivitete, tani po flas në cilësinë e qytetarit jo në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit ngase vërtetë më ka brengosur fakti kur e kam parë atë gjendje jo të mirë të asaj fushe sportive.

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, unë po përgjigjem rreth pyetjes për rrugën “Skënderbeu”, është e vërtetë se në këtë rrugë është bërë një investim në vlerë 1,300,000.00€, në bazë të kontratës që është lidhë. Plani dinamik për rrugën “Skënderbeu”, është gjithsej 210 ditë. Në rrugën “Skënderbeu” nuk mund të themi se nuk është bërë zgjerimi i saj sepse në këtë rrugë është paraparë edhe përfshirja e shtegut të biçikletave, duke llogaritur dy korsitë e rrugës që janë në gjerësi 7m dhe shtegun e biçikletave në të dyja anët 1.2m si dhe një pjesë të trotuarit në gjerësi 2m. Nga diskutimet që kemi pasur më herët ka pas pyetje se cila ka qenë arsyeja që kjo rrugë mos të bëhet në 4 korsi, ne të gjithë jemi dëshmitar se jetojmë në Podujevë dhe nga situata që e shohim në atë hapësirë kemi një uzurpim të madh të pronës publike edhe kjo formë ka qenë një rregullim i gjendjes aktuale të rrugës për të cilën qytetarët kanë nevojë. Tani ju mund të bëni pyetje pse nuk bëhet zgjerimi i rrugës, në qoftë se ju apo edhe qytetarët e konsideroni shumë të nevojshme një rrugë me gjatësi 2 km ne gjithsesi do ta kishim bërë zgjerimin e saj, mirëpo është pjesa tjetër që ka të bëjë me ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe ne i kemi gjithë ato objekte të ndërtuara para vitit 2018, kur nuk ka një ligj të veçantë edhe po të kishim dashur ne të marrim veprime është dashur të presim një ligj të veçantë për trajtimin e atyre objekteve të cilat janë vendosur në afërsi të rrugës, pra kjo ishte sa i përket rrugës “Skënderbeu”. Plani dinamik është duke u hartuar dhe në muajin janar 2023 është afati përfundimtar i punimeve dhe normalisht ne jemi duke tentuar sa më shpejtë që të përfundoj ky projekt kur e dimë se ka ngecje në qarkullim të kësaj rruge.

**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, nëse projekti për atë rrugë është bërë për 4 korsi dhe janë ndarë 1,300,000.00€, gjatë punimeve në rrugë e keni parë se kjo rrugë nuk mund të bëhet me 4 korsi dhe tani është ndryshuar projekti që kjo rrugë të bëhet me dy korsi, çka i kontribuon kjo zgjidhjes së komunikacionit në Podujevë kur më parë kjo rrugë ka qenë me dy korsi. Projekti për ndërtimin e rrugës nëse ka qenë me katër korsi kurse ka ndryshuar dhe kjo rrugë bëhet me dy korsi atëherë duhet të ndryshoj edhe kostoja e asaj rruge.

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, fillimisht para se të përcaktohet pjesa financiare është përcaktuar gjerësia e rrugës, nuk mundemi tani të përcaktojmë vlera financiare me kosto 1,300,000.00€, kurse të ndryshoj gjerësia e saj, nuk mundemi ne të përcaktojmë vlera financiare me kosto 1,300,000.00€, dhe të ndryshoj gjerësia e rrugës prej 4 korsive në 2 korsi normalisht se do të ndryshohej edhe kostoja financiare por kjo rrugë e projektuar në këtë formë ka vlerën 1,300,000.00€, në qoftë se do ishte e paraparë ndërtimi i saj me 4 korsi vlera do të ishte më e madhe ndoshta 2,100,000.00€ apo 2,300,000.00€, sepse për çdo m<sup>2</sup> qoftë me asfalt, trotuar apo me shteg të biçikletave ka një kalkulim përkatës.

Fillimisht ajo rrugë ka qenë në një gjendje jo të favorshme sa i përket bazës dhe e gjithë pjesa tjetër gjatë gjermimit që është bërë kemi parë se e gjithë pjesa e zhavorrit ka qenë e kalbur dhe është dashur të punohet prej pjesës fillestare, pastaj janë shtuar shiritat për biçikleta. Tani ne e dimë se trend modern është bërë përdorimi i biçikletave që kanë rëndësi shumë të madhe, po ashtu edhe përgjatë pjesës së trotuarit do të ketë edhe një pjesë të madhe të gjelbërimit, po ashtu është përmirësuar edhe pjesa e kanalizimit atmosferik dhe një pjesë e ujësjellësit, pjesa e ndriçimit publik do të ndërrohet komplet e kështu me radhë. Unë mendoj se do të jetë një projekt mjaft i favorshëm për Komunën tonë.

**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, prezantimi i projektit nga ana e Komunës ka qenë si nëpër filma, por çfarë rëndësie dhe çfarë roli ka luajtur në lirim të komunikacionit në qytet, kjo është rëndësia e projektit e jo të paraqisni grafika të bukura se kjo është diçka tjetër. Të arsyetoni se pjesa e zhavorrit është kalbur nuk është term adekuat sepse zhavorri nuk kalbet, ajo rrugë është e vjetër dhe nuk mund të thoni se nuk e kemi ditur se cila është gjendja e asaj rruge deri sa kanë filluar punimet.

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, ndoshta do të jetë edhe më shumë se film kur të përfundoj ajo rrugë, çështja tjetër që ju tregova është se kjo rrugë bazën nuk e ka pasur si duhet dhe është dashur gjithsesi të punohet në këtë formë pa marrë parasysh se a do bëhet rregullimi i saj në dy apo katër korsi, gjithsesi intervenimi në këtë rrugë ka qenë i domosdoshëm. Normalisht ne kemi ardhë të bëjmë më shumë se sa dokumentar, për të mbetur në histori.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSSH, theksoi, fillimisht më vjen mirë që po i ngritni shqetësimet e qytetarëve për çka jeni të thirrur dhe për çka keni marrë votë dhe jeni këtu në Kuvendin e Komunës së bashku me ne. Mund t'ju them se është e vërtetë se ne nuk mund t'i shohim gjitha problemet që janë qoftë në infrastrukturë apo problemet tjera prandaj jemi së bashku këtu dhe duhet që këto probleme t'i ngrisim por edhe të punojmë bashkërisht që t'i zgjedhim.

Sa i përket pyetjes së znj.Arnisa Sylejmani, për atë gropën e famshme në rr."Haxhi Sadriu", është e vërtetë që kemi biseduar për këtë problem dhe në këtë foltore ju kam premtuar se ky problem do të evitohet dhe në prezencën e juaj e kam thirr menaxherin e projektit dhe operatorin dhe ju kam thënë që ta rregullojnë atë gropë, por për besë nuk kam mundur të inspektoj atë punim në atë rrugë, dhe tani po ju premtoj se nëse ky problem nuk është zgjidhur ende edhe pse kontrata është në fazën përfundimtare ky problem do të zgjidhet dhe ajo rrugë do të kthehet në gjendjen normale.

Sa i përket pyetjes së z.Ekrem Rrahmani për zgjerimin e shtretërve të lumenjve, është e vërtetë se ne i kemi dy kontrata, njëra është nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime që është mirëmbajtja dhe pastrimi i shtretërve të lumenjve, ndërsa kontrata tjetër është rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe në këtë drejtim është punuar shumë për realizimin e tyre. Në njëren kontratë të mirëmbajtja dhe pastrimi lumenjve e di se janë bërë shumë punime por unë po i them vetëm disa fshatra të cilët i mbaj në mend se ka më shumë për një përgjigje sa më adekuate, sigurisht se në fund të kontratës menaxheri është i obliguar ta përgatis raportin për punët e kryera dhe atë raport mund t'ua paraqes me detaje, por po i them disa prej tyre që i kam inspektuar duke filluar prej fshatit Dumnicë e Poshtme që është hap shtrati i lumit prej urës kryesore, është zgjeruar pjesa e sipërme e Lumit Llap në fshatin Bajçinë, gjithashtu zgjerime të shtratit të Lumit Llap janë bërë në fshatin Peran dhe në pjesë të qytetit, gjithashtu është bërë zgjerimi i kanaleve të ujërave prej tjegullores deri në fshatin Katunishtë edhe në fshatin Halabak, kemi zhvilluar punime të ndryshme dhe jemi munduar t'i përfshijmë gjitha pikat e ndjeshme ku e kemi parë të arsyeshme të intervenojmë që mos të kemi vërshime pas të reshurave atmosferike. Ndërsa në zgjerimin dhe rregullimin e shtratit të Lumit Llap janë duke u zhvilluar punime në fshatrat Llugë dhe Penuhë, për punimet që kanë mbetur në gjysmë dhe është vazhdimësi e projektit të kaluar rregullim i shtratit të Lumit Llap me gabione dhe janë duke u zhvilluar ende punimet në këtë projekt sepse ky është një projekt kapital dhe e ka dinamikën e përfundimit të punimeve përkundër faktit sepse kemi kohë edhe 1 vit në përfundimin e këtij projekti.

Ju mund t'i shihni punimet që janë duke u zhvilluar në fshatin Lluzhan, në këtë kontratë dhe krejt në fund unë ju them se falë kësaj dhe këtyre intervenimeve që janë bërë ka rastisë sivjet që të përballemi me reshjet më të mëdha dhe të kemi nivelin më të madh të ujit në Komunën tonë, këtë e them sipas matjeve të bëra dhe falë këtyre intervenimeve edhe pse kemi pasur vërshime nuk kemi pas asnjë dëm në shtëpitë e banimit edhe pse kemi pas dëme në infrastrukturë dhe dëme bujqësore.

Sa i përket trajtimit të përroskave dhe lumenjve ju e dini se kohëve të fundit ka përfunduar projekti i kolektorit në Lagjet Tovërlani dhe Shala dhe për herë të parë në këto dy lagje përkundër të reshurave të shumta nuk ka pas vërshime dhe këtë e thonë edhe banorët jo vetëm ne. Kanë qenë lagjet e para që janë vërshuar pas reshjeve atmosferike mirëpo tani falë atij kolektori në atë pjesë nuk kemi vërshime.

Sa i përket ndërtimit të Stacionit të Autobusëve, ka filluar tenderimi është marrë pëlqimi ndërsa e drejtë e secilit operator është edhe e drejta e ankesës, dhe këtu kemi pas ankesa në OSHP dhe fatmirësisht të them pas një kohe të gjatë një ditë më parë ka ardhë një vendim prej OSHP-së ku Komunës i jepet e drejta për shpalljen e operatorit dhe tani presim procedurat në vazhdim në mënyrë që t'i fillojmë punimet në

Stacionin e Autobusëve. Sa i përket tenderimit dhe vendimit, ne fillimisht kemi shqyrtuar dhe vlerësuar që i Stacionit të Autobusëve të rregullohet e që është njëri nga projektet më të rëndësishme për Komunën e Podujevës duke e marrë për bazë edhe gjendjen e komunikacionit që e diskutuam më parë.

Sa i përket rrugës Dumnicë e Poshtme-Podujevë që e ceku znj.Donjeta Sheqiri, nuk e di a e kemi diskutuar ndonjëherë këtë çështje por kjo rrugë është regjionale dhe është në përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës, përveç kësaj unë nuk e di se a i kam 4 apo 5 e-maile që i kam dërguar në Ministri për këtë problem të cilin e ka ngritë edhe drejtori i DPZHE-së z.Vigan Salihu. Përgjigje nga Ministria kemi marrë se projekti për mirëmbajtjen e rrugëve është në procedurën e ankesave dhe janë në pritje të lidhjes së kontratës e pastaj pas lidhjes së kontratës na është thënë se do të fillojnë me veprime konkrete e që besoj se do të intervenojmë në momentin që lidhet kontrata. Sa për njoftim nga ana e zyrtarëve të Ministrisë kur ka qenë e lidhur kontrata ata kanë dalë në vendin e ngjarjes së bashku me ne dhe na kanë thënë se do t'i fillojnë punimet mirëpo ndërkohë na kanë thënë se ka ndryshime të pozicioneve të kontratës dhe e kanë ndërtuar këtë shiritin shtesë në rrugën e Merdarit ky është arsyeimi i tyre se ajo kontratë është bartë në shiritin shtesë të rrugës së Merdarit. Në momentin që do lidhet kontrata e re do të rregullohet ajo rrugë e dëmtuar sepse vërtetë kjo rrugë paraqet një shqetësim ngase duhet ndërruar shiriti i rrugës për të shkuar në drejtim të fshatit Dumnicë e Poshtme.

Sa i përket pyetjes së znj.Edonë Shabani, që do të ma përcjellë përmes e-mailit shqetësimin e saj për një rrugë, i them që atë email të mos e përcjell sepse kam marrë kërkesën dhe e kam evidentuar atë rrugë dhe besoj se vitin e ardhshëm në kontratën e re për meremetimin e rrugëve dhe trajtimin e tyre me zhavorr do e përfundojmë atë rrugë

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, i nderuari drejtor, unë kam familjar në fshatrat Dumnicë e Poshtme dhe Katunishtë dhe nuk e di se ka pasur ndonjëherë vërshime në ato lokalitete që kanë qenë me prioritet, ju e dini se unë vijë nga fshati Siboc i Poshtëm dhe përgjatë fshatit tim dhe fshatrave përreth Lumi Dumnica i vërshon arat dhe bën dëme të mëdha bujqësore.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, livadhet e Duminicës së Poshtme janë livadhet më të mira që i ka Kosova dhe ato gjithëherë janë vërshuar nga Lumi Dumnica, e këto livadhe janë më të mirat që i ka Kosova, e them këtë ngase për ato livadhe edhe kam lexuar. Nëse ndokush nga ju ka për të shtuar diçka urdhëroni nëse jo ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje, gjithashtu edhe drejtorët për përgjigjet e tyre.

*Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 14:45**

**Procesverbalin e mbajti**

**Enis Sheholli**

**Nr.prot.01-060/04-0101067/22**

**Podujevë,**

**09 dhjetor 2022**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Hilmi Hoxha**